



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:139172

Datë: 29.07.2024

Numri i dokumentit: 05852771

**PKR.nr.113/22**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA,** Kryetarja e trupit gjykues Nushe Kuka Mekaj, me anëtarët e trupit gjykues-gjyqtarët Arben M.j dhe Blerta Kelmendi, me bashkëpunëtoren profesionale Elzana Kastrati, në çështjen penale kundër të akuzuarve: B. G., për shkak të 3 veprave penale të kryera në vazhdimësi *Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.2 nënpar.2.2 lidhur me par.1 e nenin 81 të KPRK-së*, B. G., E.A., B.A. dhe S.K., për shkak të dy veprave penale *Falsifikim i dokumentit zyrtar nga neni 434 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së*, B.G., për shkak të veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale *Falsifikim i dokumentit zyrtar nga neni 434 par.1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së*, E.A. dhe B.A., për shkak të veprës penale të kryer në vazhdimësi *Mashtrim nga neni 335 par.2 e 4 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së* dhe veprës penale të kryer në vazhdimësi *Mashtrim nga neni 335 par.2 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së*, dhe E.A., për shkak të veprës penale të ricilësuar *Mashtrim nga neni 335 par.2 lidhur me par.1 e nenin 81 të KPRK-së*, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për Krime të Rënda nën shenjën PP/I.nr.117/2020, të datës 03.06.2022, e përmirësuar me datë 29.06.2022, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor me datë 31.05.2024, në prezencë të mbrojtësve të të akuzuarve, të dëmtuarit D.A., e në mungesë të Prokurores së Shtetit Sahide Gashi, përfaqësuesit të të dëmtuarit av.Bujar Bërdynaj dhe të akuzuarve, publikisht bie dhe shpall, ndërsa me datë 29 korrik 2024, përpiloj këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të akuzuarit:**

**B. G.**, nga i ati .... dhe e ëma ....., e gjinisë ....., i lindur me ..... në fshatin ....., Komuna Klinë, me vendbanim në ..... rr. ...., kati III nr.13, ka të kryer Fakultetin Juridik, i divorcuar, baba i 4 fëmijëve, me profesion noter, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..... lëshuar nga MPB të R. Kosovës, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**B.G.**, nga i ati .... dhe e ëma ....., e gjinisë ....., i lindur me ..... në Klinë, ku edhe banon, rr. ...., numër 18, hyrja ....., i martuar baba i një fëmije, me profesion asistent i noterit, i gjendjes se mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, me numër personal ..... lëshuar nga MPB të R. Kosovës, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**B.A.** , nga i ati ..... dhe e ëma ....., e gjinisë ....., i lindur me ..... në fshatin ....., Komuna Klinë, me vendbanim në fshatin ....., Komuna e Klinë, ka të kryer 4 klasë të shkollës fillore, bujk, i martuar baba i 4 fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..... lëshuar nga MPB të R. Kosovës, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**S.K.**, nga i ati .... dhe e ëma ....., e gjinisë ....., i lindur me ..... në fshatin ....., Komuna Malishevë, ku edhe jeton, ka të kryer Fakultetin e Bujqësisë, i martuar baba i 6 fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..... lëshuar nga MPB të R. Kosovës, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**E.A.**, nga i ati .... dhe e ëma ....., e gjinisë ....., i lindur me ..... në fshatin ....., Komuna Klinë, me vendbanim në fshatin ....., Komuna Klinë, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i 3 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ..... lëshuar nga MPB të R. Kosovës, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**I.**

**ËSHTË FAJTOR**

I akuzuari E.A.

Për shkak se:

Me datë 18.07.2018 në Klinë, me anë të paraqitjes së rreme të fakteve me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten, në atë mënyrë që edhe pse i vetëdijshëm se pronat në .....prej 36 ari, konkretisht ngastrat me numër 01365-0, me sipërfaqe 1025 m<sup>2</sup>, nr. 01366-1, me sipërfaqe prej 856m<sup>2</sup>, nr.01366-2 me sipërfaqe 99 m<sup>2</sup>, nr. 01367-0 me sipërfaqe 1679 m<sup>2</sup>, evidentoheshin në emër të D.A. në regjistrat kadastral, të njëjtat ia shet këtu të dëmtuarit N. M., përmes babait të tij Sokol, këtu dëshmitar për shumën prej 260.000.00 (dyqind e gjashtëdhjetë mijë) €, sipas kontratës mbi shitblerjen e paluajtshmerisë të lidhur mes të pandehurit E. si shitës dhe në anën tjetër të babait të të dëmtuarit N. e S.M. si blerës të lidhur tek avokati Isa Gashi, duke përfituar kështu shumën prej 143.000.00 (njëqind e dyzet e tremijë) €.

-Me çka ka kryer veprën penale *Mashtrim nga neni 335 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së*.

Andaj në aplikim të nenit 7, 17, 41, 42 par.1, nënpar.1.1, neni 43 par.1, nënpar.1.2 dhe 1.3, 45, 46, 73, 74, lidhur me nenin 335 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 364, 365, 449 par.1 dhe 2, pika 2.6 dhe 462 par.2 të KPPRK-së, të njëjtin e:

**G J Y K O N**

**ME DËNIM BURGIMI** në kohëzgjatje prej pesë (5) vite, dënim i cili do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, dhe

**DËNIM ME GJOBË** në shumë prej pesëmijë (5000) €, dënim i cili do të ekzekutohet pesëmbëdhjete (15) ditë, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim. Kur dënimi me burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, një ditë burgim llogaritet me njëzet (20) Euro gjobë.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën në tërësi, gjykata do ta zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim. Nëse personi i dënuar e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, të paguaj shumën prej njëqind (100) € në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

Obligohet i akuzuari që në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej pesëdhjetë (50) €, në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

Revokohet masa e përkohshme e lëshuar sipas aktvendimit DKR.PP.nr.135/20.

Palët e dëmtuara N. dhe S.M. , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

## II.

**Në aplikim të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së,**

### **LIROHEN NGA AKTAKUZA**

#### *I akuzuari B. G.*

Për shkak se:

I. Me datë 13.06.2017 në Klinë, në zyrën e tij “B. G. BI” si person zyrtar – Noter e në vazhdimësi me dashje nuk i ka përmbush detyrat e tij zyrtare në kundërshtim me nenin 33, 38 e 45 par.1 dhe 2 të Ligjit mbi Noterin Nr.0/L-010, si dhe Udhëzimin Administrativ Nr.02/2012, me qëllim mundësimi të përfitimit të dobisë pasurore për tjetrin dhe atë të E. e B.A. , në atë mënyrë që ka përpiluar dhe vërtetuar me nënshkrim e vulë Autorizimin me shenjë LRP.nr.3109/2017, kinse në emër të këtu të dëmtuarit D.A. – si autorizues, pa qenë në dijeni e prezent ky i fundit dhe pa e vërtetuar më nënshkrimin e tij, me të cilin kinse e autorizonte B.A. për shitjen e të gjitha patundshmërive të evidentuara në emër të biznesit të të dëmtuarit N.T.T. “.....”, si dhe patundshmërive tjera të evidentuara në emër të tij personal, të cilat gjenden në Zonën Kadastrale Klinë dhe .....– Komuna e Klinës, që tejkalon vlerën prej 1.000.000.00 (një milion) €, si dhe se kinse se ka të drejtë që pa praninë e të dëmtuarit ta ngarkoj me barrë – hipotekë patundshmëritë në fjalë, e po në të njëjtën ditë përpilon gjithashtu edhe kontratën hipotekare me shenjë

LRP.nr.3122/2017, ref.nr.838/2017 të datës 13.06.2017 të lidhur tani në mes të B.A. si hipoteklënës në njërën anë dhe Bankës Kombëtare Tregtare (BKT tutje) në anën tjetër si hipotekmarrës, duke ua mundësuar të njëjtëve që më përdorim të këtij Autorizimi dhe Kontratës për Hipotekë, të përfitojnë shumën prej 250.00.00 (dyqind e pesëdhjetë mijë) € në emër të kredisë nga BKT.

II. Me datë 28.01.2019 në Klinë, në zyrën e tij “B. G. BI” si person zyrtar – Noter e në vazhdimësi me dashje nuk i ka përmbushur detyrat e tij zyrtare, në kundërshtim me nenin 33, 38 e 45 par. 1 e 2 të Ligjit mbi Noterin Nr. 0/L-010, si dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2012, me qëllim mundësimi të përfitimit të dobisë pasurore për tjetrin dhe atë të E. e B.A. , në atë mënyrë që duke shfrytëzuar Autorizimin me shenjë LRP.nr.3109/2017, të cilin pasi e kishte përpiluar dhe vërtetuar me nënshkrim e vulë, kinse në emër të këtu të dëmtuarit D.A. – si autorizues, pa qenë në dijeni e prezent ky i fundit dhe pa e vërtetuar më nënshkrimin e tij, me të cilin kinse e autorizonte B.A. për shitjen e të gjitha patundshmërive të evidentuara në emër të biznesit të të dëmtuarit N.T.T. “.....”, si dhe patundshmërive tjera të evidentuara në emër të tij personal, të cilat gjenden në Zonën Kadastrale Klinë dhe .....– Komuna e Klinës që tejkalon vlerën prej 1.000.000.00 (një milion) €, si dhe se kinse se ka të drejtë që pa praninë e të dëmtuarit ta ngarkoj më barrë – hipotekë patundshmëritë në fjalë, përpilon kontratën nën shenjën LRP.nr.641/2019 të shitblerjes së ngastrës P-71010027-01349-4, në sipërfaqe 500 m2, ZK .....në emër të B.A. , kinse si i autorizuar i të dëmtuarit nga D.A. – si shitës në njërën anë dhe nga ana tjetër N. M. nga fshati ....., Komuna Klinë si blerës, gjithashtu këtu i dëmtuar, duke ia mundësuar kështu E. dhe B.A. , përfitimin e shumës prej 9.000.00 (nëntëmijë) €.

III. Me datë 28.01.2019 në Klinë, në zyrën e tij “B. G. BI” si person zyrtar – Noter e në vazhdimësi me dashje nuk i ka përmbushur detyrat e tij zyrtare, në kundërshtim me nenet 33, 38 e 45 par.1 e 2 të Ligjit mbi Noterin Nr.0/L-010, si dhe Udhëzimin Administrativ Nr.02/2012, me qëllim mundësimi të përfitimit të dobisë pasurore për tjetrin dhe atë të E. e B.A. , në atë mënyrë që duke shfrytëzuar Autorizimin me shenjë LRP.nr.3109/2017, të datës 13.06.2017, të cilin pasi e kishte përpiluar dhe vërtetuar me nënshkrim e vulë, kinse në emër të këtu të dëmtuarit D.A. – si autorizues, pa qenë në dijeni e prezent ky i fundit dhe pa e vërtetuar më nënshkrimin e tij, përpilon kontratën për shitblerjen e patundshmërisë nën LRP.nr.641/2019 dhe ref.nr.144/2019 në mes të B.A. si shitës e në anën tjetër N. M. si blerës të

patundshmërive të cilat evidentohen në emër të D.A., sipas certifikatave për paluajtshmeritë 11-292-20219 dhe 11-268-2019, si njësi kadastrale me nr. P-71010027-01349-4 ZK .....në sipërfaqe prej 500 m<sup>2</sup>, e të cilat përndryshe ishin prona faktike të M. e Xh. B., si dhe parcelën me numër P-71010027-01371-0 ZK ....., në sipërfaqe 1829 m<sup>2</sup>, e cila ishte pronë faktike e të dëmtuarit M. A., duke ua mundësuar kështu përfitim në këtë mënyrë të pandehurit E. e B.A. shumën prej 143.000.00 (njëqind e dyzet e tre mijë) €.

-Me çka në vazhdimësi kishte për të kryer veprën penale *Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.2 nënpar.2.2 lidhur me par.1 e nenin 81 të KPRK-së.*

### III

Të akuzuarit B. G., E.A., B.A. e S.K.

Për shkak se:

Me datë 13.06.2017, në fshatin ....., Komuna Klinë, i pandehuri B., si person zyrtar – Noter në marrëveshje e bashkëpunim me të pandehurit tjerë i ka mundësuar të pandehurit S. të falsifikoj dokumentin zyrtar me të dhëna të rreme dhe atë Autorizimin nën shenjën LRP.nr.3109/17, në atë mënyrë që pasi i pandehuri B. përpilon autorizimin në fjalë kinse në emër të këtu të dëmtuarit D.A. si autorizues, pa qenë në dijeni e prezent ky i fundit dhe pa vërtetuar me nënshkrimin e tij me të cilin kinse e autorizon të pandehurin B., për shitjen e të gjitha patundshmërive të evidentuara në emër të biznesit të të dëmtuarit N.T.T “.....”, si dhe patundshmërive tjera të evidentuara në emër personal të të dëmtuarit të cilat gjenden në Zonën Kadastrale Klinë dhe ....., Komuna Klinës, me ndërmjetësimin e të pandehurit E. dhe B., ia dërgon autorizimin në fjalë të pandehurit S. i cili po qëndronte në shtëpinë e të pandehurit E. e pasi i njëjti e falsifikon nënshkrimin e të dëmtuarit D.në të, i pandehuri B. e vërteton me nënshkrim e vulë autorizimin në fjalë.

-Me çka në bashkëkryerje kishin për të kryer veprën penale *Falsifikim i dokumentit nga neni 434 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.*

### IV

I akuzuari B.G.

Për shkak se:

Me datë 13.06.2017, në ....., Komuna Klinë, si asistent noterial në zyrën e Noterit “B. G. BI”, ndihmon në kryerjen e veprës penale të falsifikimit të dokumentit zyrtar, në atë mënyrë që në marrëveshje me të pandehurin B. G. e E.A., e dijeninë e të pandehurit B.A. , e dërgon Autorizimin LRP.nr.3109/2017 të cilin e kishte përpiluar paraprakisht i pandehuri B. në shtëpinë e të pandehurit E.A. për t’u nënshkruar i pandehuri S.K., në vend e pa dijeninë e të dëmtuarit D.A., më të cilin kinse i dëmtuari D.e autorizon të pandehurin B., për shitjen e të gjitha patundshmërive të evidentuara në emrin e biznesit të të dëmtuarit N.T.T. “.....”, si dhe patundshmërive tjera të evidentuara në emrin e tij personal të cilat gjenden në Zonën Kadastrale Klinë dhe ....., Komuna Klinë e po ashtu se kinse se ka të drejtë që pa praninë e të dëmtuarit ta ngarkoj me barrë hipotekë patundshmërinë në fjalë.

-Me çka kishte për të kryer veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale *Falsifikim i dokumentit zyrtar nga neni 434 par.1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së.*

V

Të akuzuarit E.A. dhe B.A.

Për shkak se:

Me datë 13.06.2017 në Pejë, në Bankën Kombëtare Tregtare (BKT tutje) e në vazhdimësi, në marrëveshje paraprake mes tyre, me paraqitje të rreme të fakteve, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të pasurisë për vete, kanë vu në lajthim zyrtarët e kësaj banke që të kryejnë një veprim i cili rezulton në dëm të pasurisë së saj, në atë mënyrë që me prezantimin e autorizimit gjeneral LRP.nr.3109/2017, të falsifikuar me të cilin kinse D.A., si autorizues i të pandehurit këtu B. – si i autorizuar me Kontratë për Hipotekë LRP.nr.3122/2017 ref.nr.838/2017, përfitojnë shumën prej 250.000.00 (dyqind e pesëdhjetë mijë) € në emër të kredisë, duke lënë me këtë rast peng patundshmërinë e të dëmtuarit D., si lokalin afarist N.T.T “.....”, me numër të biznesit 80349262, ngastra nr.O-71006024-00525-17-5-2-13-0, me sipërfaqe prej 26 m2 ZK Klinë e cila pronë është vlerësuar 21.000.00 (njëzetë e njëmijë) €, si dhe patundshmëritë në emër të dëmtuarit D., të evidentuara sipas certifikatës së pronës me numër 11-2459-2017 dhe atë ngastrën P-71010027-01362-0 në sipërfaqe prej 4.444 m2, P-71010027-01363-1, në sipërfaqe prej 3.114

m2, P-71010027-01363-2, në sipërfaqe prej 3.116 m2 dhe P-71010027-01363-4 në sipërfaqe prej 3.076 m2 me 1/1 të pjesës ideale e vlerësuar 409.000.00 (katërqind e nëntë mijë) €, të cilën kredi nuk e paguajnë dhe për pasojë bankës në fjalë i shkaktojnë dëm në shumë prej 217.936.36 (dyqind e shtatëmbëdhjetë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë euro e tridhjetë e gjashtë cent) €.

Me datë 28.01.2019 në Klinë, në vazhdimësi më anë të paraqitjes së rreme të fakteve me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten, me anë të autorizimit të falsifikuar LRP.nr.3109/17 me të cilin kinse D.A. autorizon të pandehurin B. për shitjen e të gjitha patundshmërive të evidentuara në emrin e biznesit të të dëmtuarit N.T.T. “.....” si dhe patundshmërive tjera të evidentuara në emrin e tij personal të cilat gjenden në ZK Klinë dhe ....., Komuna Klinë, në atë mënyrë që në emër të kinse grancionit se pronat e shitura me herët nga i pandehuri E. do të barten në emër të dëmtuarit N., i pandehuri B. me ndërmjetësimin e të pandehurit E. lidh kontratë për shitblerjen e patudshmërisë nën LRP.nr.641/2019 dhe ref.nr.144/2019 tek noteri B. G. me të cilën e bartë patudshmëritë të cilat evidentohen në emër të D.A., sipas certifikatës për paluajtshmëritë 11-292-20219 dhe 11-268-2019 si njësi kadastrale me nr.P-71010027-01349-4 ZK .....në sipërfaqe prej 500 m2, e të cilat përndryshe ishin prona faktike të M. dhe Xh. B., si dhe parcelën me nr. P-71010027-01371-0 ZK .....në sipërfaqe prej 1829 m2, e cila ishte pronë faktike e të dëmtuarit M. A., duke i shkaktuar kështu dëme të dëmtuarit N., në shumën prej 143.000.00 (njëqind e dyzetë e tre mijë) €.

-Me çka si bashkëkryerës në vazhdimësi kishin për të kryer veprë penale *Mashtrim nga neni 335 par.2 lidhur me par.1 e nenet 31 e 81 të KPRK-së.*

Në kuptim të nenit 453 par.1 të KPRK-së, shpenzimet procedurale bien në buxhet të Gjykatës.

Të dëmtuarit D.A., M. A., H.A., M. B., Xh. B., N. M., Banka Kombëtare Tregtare, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

## **A r s y e t i m**

### *Historiku i rastit*

Me datë 03.06.2022, Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngrit Aktakuzë nën shenjën nën shenjën PP/I.nr.117/2020, e përmirësuar me datë 29.06.2022, kundër të akuzuarve: B. G., për shkak të 3 veprave penale *Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar*



nga neni 422 par.2 nënpar.2.2 lidhur me par.1 e nenin 81 të KPRK-së, B. G., E.A., B.A. dhe S.K., për shkak të dy veprave penale *Falsifikim i dokumentit zyrtar nga neni 434 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, B.G.*, për shkak të veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale *Falsifikim i dokumentit zyrtar nga neni 434 par.1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, E.A. dhe B.A.*, për shkak të veprës penale të kryer në vazhdimësi *Mashtrim nga neni 335 par.2 e 4 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së* dhe veprës penale të kryer në vazhdimësi *Mashtrim nga neni 335 par.2 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së* dhe E.A., për shkak të veprës penale të kryer në vazhdimësi *Mashtrim nga neni 335 par.2 lidhur me par.1 e nenin 81 të KPRK-së*.

Me këtë lëndë, si gjyqtare e çështjes, jam ngarkuar me datë 14 qershor 2022.

Në shqyrtim gjyqësor të akuzuarit nuk janë deklaruar fajtor për veprat penale që u janë vënë në barrë, pas leximit të aktakuzës së përmirësuar, andaj gjykata ka kaluar në fazën e administrimit të provave.

Seanca e shqyrtimit gjyqësor, ka filluar rishtas konform nenit 307 par.1 të KPRK-së, meqenëse ka ndryshuar përbërja e trupit gjykues.

### Fjala hyrëse

Prokurorja e Shtetit Sahide Gashi, ka mbetur pranë fjalës hyrëse të dorëzuar me shkrim në seancën e datës 06.03.2023, në të cilën mes tjerash ka thënë se pas administrimit të provave dhe dëgjimit të dëshmitarëve të propozuar në aktakuzë, padyshim se do të vërtetohet fajësia e të akuzuarve sipas aktakuzës.

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit D.A., av.Bujar Bërdynaj, e ka mbështetur fjalën hyrëse të prokurores së shtetit.

Të dëmtuarit D.A., M. A., Xh. B., M. B., si dhe përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarës Bankës Kombëtare Tregtare, e kanë mbështetur fjalën hyrëse të prokurores së shtetit.

Mbrojtësi i të akuzuarit B. G., av. Gëzim Baloku, ka mbetur pranë fjalës hyrëse dhënë me datë 06.03.2023, duke shtuar se gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor asnjë provë e vetme që është propozuar të administrohet nga ana e prokurorisë, nuk do të vërtetohet se i akuzuari B. G., ka kryer veprë

penale që i vihet në barrë. Prokuroria pretendon se i njëjti ka shkelur Ligjin për Noterinë, mirëpo me rastin e administrimit të provave do të vërtetohet pafajësia e tij në veçanti me provën e paraqitur nga mbrojtja edhe pse prokuroria ka pas për obligim që ta dorëzoj, do të vërtetohen konstatimet e Odës së Noterëve, lidhur me veprimet e ndërmarra nga i akuzuari B.. Ai tha se prokuroria nuk e ka paraqitur si provë autorizimin gjeneral të bërë nga vet i dëmtuari D.A., i cili edhe më parë ka dhënë autorizim të akuzuarit E., për të hipotekuar pronat në fjalë e të cilat më pas janë liruar nga kjo hipotekë, i cili autorizim është aktual ende.

I akuzuari B. G., e ka mbështet në tërësi fjalën hyrëse të mbrojtësit të tij.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.G., av.Ardian Deskaj në fjalën e tij hyrëse ka mbetur pranë fjalës hyrëse të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 06.03.2023, duke shtuar se kur e ka dhënë fjalën hyrëse, nuk e ka pas në posedim deklaratën e të dëmtuarit kryesor D.A., dhe pikërisht nga ajo deklaratë do të vërtetohet se i akuzuari B., është mashtruar nga E.A. dhe Q. B..

I akuzuari B.G., e ka mbështet në tërësi fjalën hyrëse të mbrojtësit të tij.

Mbrojtësi i të akuzuarit E.A., av.Blerim Ademaj, ka mbetur pranë fjalës hyrëse të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 06.03.2023, ku mes tjerash ka thënë se me provat që do të administrohen dhe me vetë mbrojtjen e të akuzuarit do të vërtetohet pafajësia e tij.

I akuzuari E.A., e ka mbështet në tërësi fjalën hyrëse të mbrojtësit të tij.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.A. , av.Besim Ahmetaj e ka mbështetur fjalën hyrëse të kolegëve të tij avokatë, duke shtuar se deri me tani prokuroria ka dështuar të provojë se i mbrojturi i tij e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë dhe se gjatë shqyrtimit dhe administrimit të provave të propozuara nga ana e prokurorisë do të vërtetohet pafajësia e tij.

I akuzuari B.A. , e ka mbështetur në tërësi fjalën hyrëse të mbrojtësit të tij.

Mbrojtësi i të akuzuarit S.K., av.Agim Shala, ka mbetur pranë fjalës hyrëse të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 06.03.2023, duke shtuar se gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor pa dyshim do të vërtetohet se i akuzuari në fjalë është i pafajshëm.

I akuzuari S.K., e ka mbështet në tërësi fjalën hyrëse të mbrojtësit të tij.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor janë dëgjuar dëshmitarët si vijoni:

I dëmtuari/dëshmitari D.A., mes tjerash ka thënë se E. dhe B.A. , i ka vëllezër, ndërsa me të akuzuarin S.K., është në miqësi, përkatësisht është vëllai i bashkëshortes së B.A. , derisa të akuzuarin B. dhe B.G., i njeh pasi që ka qenë klient i rregullt i noterit B. G..

Në vitin 2003-2004, kishte hap një biznes në bashkësinë familjare ku ka qenë dhe pronar i biznesit N.T.T. “.....” me seli në Klinë. Pas tre vitesh është ndarë nga bashkësia familjare, biznesi kishte mbetur në emrin e tij, por i menaxhuar nga vëllai i tij këtu i akuzuari E.. Në vitin 2005-2006, kanë blerë një pronë nga serbet në fshatin ....., rreth 1.27 ha, prona është paguar nga të gjithë vëllezërit në mënyrë proporcionale dhe është bartur në emrin e tij. Pas e kanë shkëputur bashkësinë familjare, prona është ndarë në 6 pjesë, për të 6 vëllezërit sa ishin.

Motrës Xh. dhe dhëndrit M. B., të cilët jetojnë në Francë, në vitin 2010 tha se u ka shitur një pronë prej 5 ari në fshatin ....., në vlerë prej 25.000 Euro, e cila shumë e të hollave është paguar në para të gatshme dhe prezent ka qenë vëllai i tij E., mirëpo kontratë nuk kishin përpiluar, pasi që prona ende nuk ishte parcelizuar dhe ka mbetur në emër të tij. Në atë pronë motra dhe dhëndri tha se kanë hyrë në posedim dhe kanë ndërtuar një shtëpi.

Në vitin 2012 deri në gusht të vitit 2017, kishte qenë në vuajtje të dënimit në Burgun e Dubravës dhe pasi i kishte vuajtur 2/3 e dënimit, i është mundësuar dalja në vikend. Nuk i kujtohej se a i kishte dhënë vëllait të tij E. autorizim, mirëpo tha se në kuadër të biznesit që kishin personalisht ka punuar me kamion, ndërsa E. me autobusë dhe për të pasur mundësinë e qarkullimit, derisa ishte në vuajtje të dënimit, i kishte dhënë autorizime E. edhe pse sa herë i kishte dhënë autorizim e kishte pyetur se mos ka të bëjë me ndonjë kredi apo diçka tjetër, mirëpo E., i kishte garantuar se autorizimi ka të bëjë vetëm për qarkullim me autobusë dhe kamion.

Sa i përket datës 13 qershor 2017, ai tha se nuk ka qenë në pushim vikendi dhe pasi i është prezantuar autorizimi LRP.nr.3109/2017 i datës 13.06.2017, tha se në këtë autorizim nuk qëndron nënshkrimi i tij, i cili autorizim kishte rezultuar të jetë i falsifikuar dhe këtë e kishte kuptuar pasi ishte liruar nga vuajtja e dënimit dhe atë në kohën kur kishte udhëtuar për Itali, për të punuar, pasi ishte kontaktuar nga BKT të cilët përmes aplikacionit “Viber”, e kishin njoftuar

se ka një kredi të papaguar. I befasuar, tha se kishte reaguuar por nga banka i është thënë se në emër të tij ishte autorizuar vëllai B.A. , që ta marr kredinë, ai ka reaguuar sërish dhe pasi ndërpreu lidhjen, kontakton vëllain e tij E.un, duke e pyetur se cila ishte arsyeja e thirrjes nga BKT, mirëpo E.u, i kishte thënë se mund të jetë një keqkuptim, se kinse nuk kishte të bëjë me këtë.

Me tej shtoj se, për t'u siguruar ka kontaktuar noterin B. G., të njëjtin e ka pyetur lidhur me autorizimin dhe nga ai është thënë se po ju e keni autorizuar vëllain tuaj E.un, për të marrë kredi dhe për të vënë në hipotekë pronat, andaj dhe për të verifikuar nëse ishte dhënë autorizimi nga ana e tij, kishte kërkuar nga noteri që t'i dërgohej një kopje e autorizimit dhe pasi pranon atë kopje të autorizimit, verën se nuk ishte i nënshkruar nga ana e tij dhe se në atë kohë sa ishte në vuajtje të dënimit asnjëherë B.u, nuk kishte qenë për të marrë ndonjë autorizim, siç nuk kishte qenë as në kohën kur ishte në pushim vikendi.

Me t'u kthyer në Kosovë, në prezencë S.N. dhe A.A., e pyet E.un, lidhur me autorizimin dhe aty E.u, pranon se të gjitha i kishte bërë vetë, duke e lutur njëkohësisht që mos ta raportojë rastin në polici, por pasi ka kuptuar se ishin bërë edhe disa shitje të patundshmërive dhe e kishte të pamundur të kryejë obligimin e kredisë ku dhe ishin në hipotekë disa prona, nuk ka parë zgjidhje tjetër, e aq më tepër ku kishte kuptuar se ishte i përfshirë dhe B.A. e miku i tyre S.K.. Shumë e kredisë tha se ka qenë 250.000 Euro dhe për këtë shumë në hipotekë ka qenë e gjithë prona e cila ishte blerë në fshatin .....dhe ka qenë edhe e ndarë fizikisht në parcela, por jo e regjistruar në regjistrat kadastral dhe E.u më vonë ka arritur që pjesën e vëllait të tij M. A., ta heqë nga hipoteka, mirëpo në hipotekë kishte mbetur shtëpia e E.ut, një lokal në Klinë, me sa ai ishte në dijeni në hipotekë kishte qenë dhe biznesi, derisa për pjesën e Xh. dhe dhëndrit M., tha se ajo nuk ishte në hipotekë, mirëpo kjo pronë pra e motrës së tyre, ishte shitur N. M. dhe të gjitha këto janë bërë duke e shfrytëzuar autorizimin në fjalë, ku sipas tij iu është shkaktuar dëm shumë i madh, pasi banka të gjitha këto prona i ka tjetërsuar pra i ka bartë në emër të saj.

Lidhur me kontratën e kredisë, ai tha se e ka parë se në atë kontratë është nënshkruar bashkëshortja e tij, përkatësisht u sqarua se bashkëshortja i kishte thënë se vëllai i tij E.u, e ka dërguar tek noteri për të nënshkruar disa dokumente, por sipas saj ajo nuk kishte qenë në dijeni se çfarë ishte duke nënshkruar dhe pasi noteri e sheh të frikësuar, e pyet E.un, se a është në dijeni për dhënien e pëlqimit lidhur me pronat që do të hipotekohen.

Sa i përket deklarimit të tij se nuk kishte dhënë asnjëherë autorizim për marrje të ndonjë kredie, apo për lenie në hipotekë të pronave nga mbrojtësi i të akuzuarit B. G., i është prezantuar një autorizim i datës 25.07.2012 dhe pasi e ka konfirmuar nënshkrimin dhe i është lexuar përmbajtja i njëjti ka pohuar se këtë autorizim ia kishte dhënë E.ut, i cili autorizim kishte të bëjë me marrje të kredisë dhe vënien në hipotekë të pronave të njëjta të cilat ishin hipotekuar më vonë dhe për shitjen e patundshmërive i cili autorizim ishte ende valid.

Lidhur me të hollat që janë marrë kredi, ai tha se 100.000 Euro, janë derdhur tek Q. B., derisa të tjerat në emër të personave të tjerë, por nuk ishte shumë i sigurt.

I dëmtuari/dëshmitari M. B., mes tjerash ka thënë se vëllezërit A., i ka miq, pasi të njëjtit janë vëllezërit e bashkëshortes së tij dhe se në vitin 2015, se bashku me familjen e tij kishte emigruar në Francë, dhe deri në vitin 2019 nuk ka pasur mundësi të vijë në Kosovë, për shkak të statusit të qëndrimit.

Në vitin 2010, nga vëllai i bashkëshortes së tij D.A., e kishte blerë një pronë me sipërfaqe prej 5 ari, në fshatin ....., Komuna Klinë dhe paratë ja kishte dhënë në dorë, mirëpo prona nuk ishte bartur asnjëherë në emër të tij edhe përkundër se kishte hyrë në posedim të qetë, pasi dhe kishte ndërtuar shtëpi. Me të ardhur në Kosovë, pra në vitin 2019, nga një person i quajtur Q. B.ja, kishte kuptuar se E.a, ia kishte shitur pronën, por se sipas tij ajo do t'i kthehej së shpejti. Duke mos i besuar ka kërkuar nga B.A. , që të verifikojë në librat kadastral, se a ishte e vërtetë dhe në fund nga miku i tij H., i cili jeton në Zvicër dhe kishte raporte me të mira, ishte njoftuar se prona e tij kishte dal në emër të S. dhe N. S..

Me të marrë këtë informacion, ka kërkuar nga B.a, që t'i jap sqarim, mirëpo ai i kishte thënë se është mashtruar nga E.a dhe nuk kishte qenë në dijeni se çfarë i kishte dhënë për të nënshkruar E.a dhe sot e kësaj dite, ajo pronë ende është në emër të këtyre personave dhe për këtë është ushtruar padi në gjykatë, për anulim të kontratës edhe përkundër se ende e ka në posedim, ngase personat që e kanë blerë nuk kanë hyrë asnjëherë në posedim.

I dëmtuari/dëshmitari M. A., mes tjerash ka thënë se të akuzuarit E. dhe B.A. , si dhe të dëmtuarin D.A., i ka vëllezër, të akuzuarin S.K. e ka mik, ndërsa të akuzuarit B. dhe B.G., nuk i njeh.

Pas luftës, në vitin 2005, tha se e kishte blerë një pasuri në fshatin .....dhe për të njëjtën kishte paguar shumën e të hollave prej 100.000 Euro, përmes llogarisë së vëllait të tij E.ut dhe për këtë i ka ofruar dhe provat.

Pronën të cilën e kishte blerë e ka bartur në emër të vëllait të tij D., nën arsyetim se pas vdekjes së babait besimi më i madh ishte tek vëllezërit D. dhe E.A.. Para një vitit, pra në vitin 2022, me të ardhur në Kosovë kishte kërkuar nga vëllai i tij E.u, që prona të kalojë në emër të tij, mirëpo nga i njëjti ishte njoftuar se për momentin nuk mund të bartet pasi që ishte lënë si peng tek N. M..

Për të verifikuar se si qëndronte e vërteta, ka shkuar personalisht në zyrën kadastrale dhe ka vërtetuar se prona tani më ishte shitur dhe kishte kaluar në emër të N. M., ashtu që në muajin tetor derisa ishte në një lokal në Klinë, ka takuar vëllain e S.M. , I., i cili e kishte pyetur se ku ishte E.u, pasi që ai pretendonte se familja e tyre ishte mashtruar nga E.u dhe me të marrë këtë informacion e ka njoftuar policinë.

Ka shtuar se pjesa e tjetër në sipërfaqe prej 24 ha ishte vënë në hipotekë dhe ajo parcelë është e përbashkët me parcelën e vëllait të tij D.t, dhe të dyja si tërësi prej 44 ari janë hipotekuar.

Sa i përket shitjes së pronës dhe vënies në hipotekë të pjesës tjetër të pronës e kishte kuptuar, pasi ato kishin dal në ankand publik nga Banka Kombëtare Tregtare.

Se këto veprime i kishte bërë të gjitha vëllai i tij E.a e ka kuptuar nga i akuzuari B. dhe D., pasi që të dy ishin mashtruar nga E.a.

I dëmtuari/dëshmitari H.A., mes tjerash ka thënë se të akuzuarit E. dhe B.A. , si dhe të dëmtuarin D.A., i ka vëllezër, të akuzuarin S.K. e ka mik, ndërsa të akuzuarit B., e njeh pas rastit.

Në fshatin ....., ai dhe vëllezërit e tij, i kanë shtëpitë dhe rreth 30 ari truall. Shtëpia e tij është e regjistruar në kadastër, mirëpo toka ka qenë në emër të vëllait D.t. Patundshmëritë tha se janë krijuar si rrjedhojë e të hollave që i ka dërguar ai dhe vëllai i tij M. nga jashtë vendit.

Lidhur me rastin tha se e ka kuptuar nga djali tij kur ka qenë në pushime në Kosovë, para 4 apo 5 viteve, i cili nga një postier kishte pranuar një dokument nga banka sipas të cilit thuhej se

shtëpia e tij është vënë nën hipotekë si rrjedhojë e një kredie në vlerë prej 250.000 Euro. Pas këtij njoftimi nga Banka Kombëtare Tregtare e kupton se shtëpia ishte vënë në hipotekë nga vëllai i tij E.a edhe përkundër se ajo ka qenë në emër të D.A..

Pas kësaj bisedon me vëllezërit e tij, B.a i thotë se e ka mashtruar E.a dhe nuk e ka ditur se për çfarë po nënshkruan, E.a i kishte thënë se i ka do borxhe dhe se do t'i kthehet prona e tij, ndërsa D., i kishte thënë se krejt Kosova është në kredi dhe mos e bënë të madhe këtë punë.

Tutje ka shtuar se D. dhe E.a kanë pasur raporte shembullore, ndërsa pas daljes së D.t nga burgu, i kanë prishur raportet. Ai pohoj se D. e ka ditur për marrje të kredisë dhe vënie të pronave në hipotekë nga E.a.

Me propozimin e të akuzuarit B. G., është dëgjuar dëshmitarja E. A..

Dëshmitarja E. A., tha se të dëmtuarin D.A. e ka bashkëshort, të akuzuarit E. dhe B. kunetër, të akuzuarin S.K. kushëri, ndërsa të akuzuarit B. dhe B.G., nuk i ka në lidhje gjaku, por të akuzuarin B. e njeh.

I kujtohet që në vitin 2017 apo 2019, ka qenë në zyrën noteriale tek i akuzuari B. dhe pa i lexuar asgjë noteri, ka nënshkruar pëlqim për shitje të një autobusi, e detyruar nga kunati i saj E.a. E.a i kishte thënë se ka një problem me një person, andaj dhe hera e parë dhe e vetëm që kishte shkuar tek noteri ishte ajo.

Tutje, ajo mohoj që ka shkuar tek noteri në kohën kur bashkëshorti i saj D. ka dal nga burgu, e po ashtu mohoj të ketë qenë në dijeni për marrjen e kredisë objekt akuze, duke shtuar se për kredinë dhe pronat e vëna në hipotekë e kanë kuptuar kur kanë qenë në Itali, pra pasi D. ka dal nga burgu.

Dëshmitari Sh. H., ka thënë se me profesion është noter, të akuzuarin B. G., e njeh si noter, ndërsa asnjërin nga të akuzuarit nuk i ka në lidhje gjaku.

I kujtohet që me datë 28.12.2021, si anëtarë i kryesisë së Odës së Noterëve, ka marrë pjesë në dhënien e një mendimi të kërkuar nga ana e prokurorisë. Në këtë mendim ai tha se nuk i kanë interpretuar dispozitat ligjore, por kanë dhënë opinion e tyre lidhur me rastin konkret.

Sa i përket rrethanës se a ka të drejtë noteri që një autorizim gjeneral t'ia delegoj dikujt tjetër nga zyra e tij, ai tha se përpilimin e aktit noterial mund ta bëjë bashkëpunëtori apo i punësuar në zyrën noterial, por noteri duhet të jetë prezent si në zyre ashtu dhe jashtë zyrës me rastin e marrjes së nënshkrimit nga klienti.

Autorizimi tha se është i ligjshëm edhe në rast kur nuk konstatohet në autorizim vendi se ku është duke u marrë nënshkrimi, për shkak të mungesës së mjeteve për printim, ndërsa procesverbali noterial tha se nuk ka nevojë të përpilohet.

Tutje tha se autorizimi mund të përpilohet me të dhënat që i jep familjari, me kusht që ato t'i lexohen dhe autorizimdhënësi të pajtohet me atë se çfarë është konstatuar.

Ka shtuar se ka shumë kërkesa për nënshkrim të autorizimit jashtë zyrës për shkak të gjendjes shëndetësore të klientëve, e që këto raste për dalje në teren nuk përfshihen me ligj, por kjo është e rregulluar me udhëzim administrativ.

Me propozimin e prokurores i mbështetur nga palët në procedurë është lexuar deklarata e dëshmitarit S.M., i cili mes tjerash ka thënë nga i akuzuari E.A., ka blerë patundshmërinë në vlerë prej 260.000 Euro, për parcelat numër 01349-4 në sipërfaqe prej 500 m<sup>2</sup>, nr. 01365-0 në sipërfaqe prej 10.25m<sup>2</sup>, nr. 01366-1 në sipërfaqe prej 856 m<sup>2</sup>, nr. 01366-2 në sipërfaqe prej 99m<sup>2</sup>, nr. 01367-0 në sipërfaqe prej 1679 m<sup>2</sup>, sipas marrëveshjes verbale në total me sipërfaqe prej 36 ari. Këto parcela janë bartur në emër të djalit të tij N. M. me datë 11.02.2019 si dhe parcelat me numër 01394-4 me sipërfaqe prej 500 m<sup>2</sup> dhe nr. 01371-0 me sipërfaqe 1829m<sup>2</sup> janë bartur po të njëjtit. Me datë 29.01.2029 dëshmitari ka paguar vlerën prej 80,000.00 Euro në xhironlogarinë e I.A. dhe vlerën prej 61,700.00 Euro në xhironlogarinë e E.ut dhe një pjesë të të hollave E.ut i janë dhënë para të gatshme nga familja eballi. Dëshmitari deklaroi se dëmi i është shkaktuar në vlerë prej 143,000 Euro.

Prokurorja e Shtetit në seancën e datës 13.03.2024, ka heq dorë nga dëgjimi i dëshmitares N. M. dhe Xh. B..

Janë administruar provat materiale si në vijim:



- Raporti i policit Sulltan Islamaj i datës 03.02.2020;
- Autorizimi me numër LPR.nr.3109/2017 i datës 13.06.2017;
- Raporti i Ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë me numër AKF/20219-3495/2019-3112 i datës 26.12.2019;
- Kontrata mbi kredi bankare me numër 8206/17 e datës 13.06.2017;
- Kontrata mbi hipotekën me numër LRP.nr.3122/2017 dhe Ref.nr.838/2017 e datës 13.06.2017;
- Marrëveshja mbi pëgun numër 8206/17 e datës 13.06.2017;
- Procesverbali. lidhur më vlerësimin e patundshmërisë e lënë hipotekë nga BKT i datës 13.06.2017;
- Certifikatat e paluajtshmerisë me numër 11-2459-20217 dhe nr.11-2464-2017 të datës 12.05.2017 të cilat evidentohen në emër të N.T.T. “.....” lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunës së Klinës;
- Kopjet e planit të paluajtshmerive me numër 11/2299 të datës 21.04.2017 dhe numër 11/2273 e datës 21.04.2017;
- Certifikata e paluajtshmerisë me numër e datës 10.01.2017 dhe datës 10.08.2021 të cilat evidentohen në emër të D.A., lëshuar nga Zyra Kadastrale e Komunës Klinës;
- Certifikatat e paluajtshmerisë e datës 05.11.2021 e cila evidentohet në emër të N. M. lëshuar nga Zyra Kadastrale e Komunës Klinës;
- Certifikata e regjistrimit të biznesit me numër 80349262 e datës 27.04.2009 në emër të N.T.T. “.....”;
- Raporti i kontrollit nga Administrata Tatimore e Kosovës me numër 2017-08/2019 i datës 02.09.2020;
- Deklarata mbi dëmin e shkaktuar nga BKT me numër të protokollit 52559 e datës 17.11.2021;
- Aktvendimi për regjistrimin e të drejtave në regjistrin e të drejtave të pronës së paluajtshme me numër 10-921b-2019 i datës 26.11.2019;
- Kontrata mbi shitblerje të patundshmërisë me numër LRP.nr. 641/2019 dhe Ref.Nr.144/2019 të datës 28.01.2019;
- Kontrata mbi shitblerjen e patundshmërisë e datës 18.07.2018 ndërmjet palëve kontraktuese E.A. dhe S.M. ;
- Certifikatat e patundshmërisë dhe kopjet e planit me numër 11-292-20219 dhe 11-268-2019 të datës 28.01.2019 dhe datës 24.01.20219 lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunës së Klinës;
- Historiati i paluajtshmerive me numër 761, 765/2022 i datës 17.03.2022;
- Aktvendimi mbi regjistrimin e hipotekës me numër protokollit 440/2017 i datës 14.06.2017;

- Certifikata e paluajtshmerisë e datës 22.03.2022 lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunës së Klinës;
- Tri Historiatet të paluajtshmerive me numër 101/2022 i datës 14.01.2022 lëshuar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi;
- Njoftimi për shitjen/qiradhënien e aseteve të bankës pasuritë e paluajtshme nga BKT;
- Propozimi për përbarim i Bankës Kombëtare Tregtare me numër protokolli 45061 i datës 10.04.2019;
- Deklarata e ekspertit Aliriza Beshi e dhënë në prokurori me datë 23.03.2022;
- Urdhri i përbaruesit privat Zija Bala me numër P.nr.194/19 i datës 19.07.2019;
- Konkluzioni i përbaruesit privat me numër P.nr.194/19 i datës 19.07.2019, si dhe foto-dokumentacioni.
- Raporti i vlerësimit të paluajtshmerisë nga vlerësuesi Samir Lleshi i datës 08.03.2021

Provat e propozuara nga mbrojtja

- Një deklaratë së bashku me autorizim gjeneral dhënë nga i dëmtuari D.A. datës 13.12.2012, në emër të biznesit “.....”;
- Autorizimi gjeneral që përfshinë disa prona në emër individual po ashtu vërtetuar në gjykatë i datës 25.07.2012;
- Shkrese nga Agjencia Kosovare e Biznesit e nxjerr nga faqja e internetit me datë 09.02.2023;
- 3 kontrata me numër rendor 3985/2017 e datës 21.07.2027, kontrata LRP.nr.4015/17 e datës 27.04.2017 dhe kontrata LRP.nr.4027/17 e datës 24.07.2027;
- Tri certifikata të pronës me numër P-71010027-01375-1, P-71010027-01381-1, P-71010027-01376-0;
- Një pëlqim me autorizim LRP.nr.1269/2015,i datës 15.04.2015 dhënë nga E. A. bashkëshortja e të dëmtuarit D.;
- Një parashtesë ku PTHDKR në Pejë i është drejtuar BKT-së me datë 27 tetor 2020, që të përgjigjet në disa pyetje lidhur me kredinë e marrë në emër të E.A.;
- Mendimi i përpiluar nga përfaqësues të Odes së Noterëve të Kosovës numër të referencës 4/22 i datës 24.01.2022.

Në raportin e policit Sulltan Islamaj i datës 03.02.2020, është përshkruar se i akuzuari B. G. dhe E.A., kanë ndërmarrë veprime inkriminuese në drejtim të veprës penale nga neni 390 të KPRK-së, si dhe 414 të KPRK-së.

Nga autorizimi me numër nën LPR.nr.3109/2017 i datës 13.06.2017, i pretenduar si i falsifikuar, rezulton se D.A., si pronar i biznesit individual N.T.T. “.....”, i ka bartur të gjitha të drejtat dhe detyrimet tek vëllai i tij B.A. .

Nga raporti i Ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë me numër AKF/20219-3495/2019-3112 i datës 26.12.2019 rezulton se pas ekspertimit, nënshkrimi në dokumentet e evidentuara si në dëshminë #1 dhe nënshkrimet mostra të njohura të evidentuara në dëshmitë #2, 3, nuk janë shkruar nga i njëjti person.

Nga kontrata mbi kredinë bankare me numër 8206/17 e datës 13.06.2017, rezulton se Banka Kombëtare Tregtare, Dega Kosovë, në cilësi të kredihënësit, ka lidhur kontratë me kredimarrësit biznesin N.T.T. “.....” dhe D.A., bashkë-kredimarrës ka qenë D.A., ndërsa garantues D.A. dhe B.A. , për shumën e kredisë në vlerë prej 250.000 Euro.

Nga kontrata mbi hipotekën me numër LRP.nr.3122/2017 dhe Ref.Nr.838/2017, rezulton se me datë 13.06.2017, është lidhur kontrata në mes të Bankës Kombëtare Tregtare si kredihënëse dhe kredimarrësi B.A. , përfaqësues sipas autorizimit me numër LRP.nr.3109/20, i biznesit individual N.T.T. “.....”, me pronar D.A., me qëllim të sigurimit të detyrimeve sipas kontratës me numër 8206/17 i datës 13.06.2017.

Nga marrëveshja mbi pengun numër 8206/17 e datës 13.06.2017, rezulton se pengdhënësi Banka Kombëtare Tregtare-Dega në Kosovë dhe pengdhënësi N.T.T. “.....”, e përfaqësuar nga D.A., ndërsa sipas autorizimit LRP.3109/2017 i datës 13.06.2017, të përfaqësuar nga B.A. , ka lënë peng llogaritë bankare në emër të D.A. dhe të N.T.T “Florim Trans”. Këto llogari bankare dhe qarkullimi i mjeteve në këto llogari gjerë në pagimin-kthimin definitiv të kredisë dhe interesave që dalin nga kredia e siguruar.

Nga procesverbalin lidhur më vlerësimin e patundshmërisë e lënë hipotekë nga BKT, rezulton se BKT me datë 13 qershor 2017, ka bërë vlerësimin e patundshmërive të lëna në hipotekë nga kredimarrësi dhe në bazë të vlerësimit të tyre nga komisioni është konstatuar se vlera e tyre është 430,000 Euro.

Nga certifikatat e patundshmërisë me numër 11-2459-20217 dhe nr.11-2464-2017 të datës 12.05.2017, rezulton se njësia kadastrale O-71006024-00525-17-5-2-13-0, Zona Kadastrale Klinë, evidentohet në emër të N.T.T. “.....” lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunës së Klinës.

Nga kopja e planit e datës 21.04.2017, janë paraqitur parcelat me numër 1363-1, 1363-2, 1363-3, 1363-4, me pronar D.A. 1/1.

Nga certifikata e patundshmërisë me numër 10-12017 e datës 10.01.2017, e lëshuar nga Zyra Kadastrale e Komunës së Klinës, rezulton se në emër të D.A., kanë qenë disa prona dhe 6 prej tyre kanë qenë në hipotekë në Bankën NLB, PCB dhe BKT.

Nga certifikata e palujtshmërisë e datës 05.11.2021 e lëshuar nga Zyra Kadastrale e Komunës së Klinës, rezulton se njësia kadastrale me numër P-71010027-01371-0 me sipërfaqe prej 1829 evidentohet në emër të N. (Sokol) M..

Nga certifikata e regjistrimit të biznesit me numër 80349262 e datës 27.04.2009, rezulton se biznesi individual N.T.T. “.....”, është regjistruar me datë 01.12.2000 në ARBK.

Nga raporti i kontrollit nga Administrata Tatimore e Kosovës me numër 2017-08/2019, rezulton se me datë 28.02.2020, biznesi individual N.T.T. “.....”, është inspektuar nga inspektorët e Administratës Tatimore.

Nga deklarata mbi dëmin e shkaktuar e parashtruar nga BKT me numër të protokollit 52559 e datës 17.11.2021, rezulton se dëmi i shkaktuar në raste se pronat kthehen në gjendje të mëparshme, sipas tyre do të ishte në vlerë prej 214,718.18 Euro në emër të detyrimeve sipas Kontratës së Kredisë Nr.8206/17 të datës 13.06.2017 dhe shuma prej 3,218.18 Euro në emër të shpenzimeve përmbartimore.

Nga aktvendimi për regjistrimin e të drejtave në regjistrin e të drejtave të pronës së palujtshme me numër 10-921b-2019 i datës 26.11.2019, rezulton se Zyra Kadastrale e Komunës së Klinës, sipas kërkesës së BKT, ka aprovuar kërkesën për bartjen e posedimit kreditimit/hipoteka, sipas aktit juridik urdhërit përmbartues P.nr.194/2019 të datës 07.08.2019.

Nga kontrata mbi shitblerje të patundshmërisë me numër LRP.nr.641/2019 dhe numër të referencës 144/2019 të datës 28.01.2019, rezulton se B.A. , i autorizuar nga vëllai i tij D.A., ka lidhur kontratë për shitblerjen e patundshmërisë me N. M., për patundshmërinë në Zonën Kadastrale ....., për çmimin kontraktues prej 9.000 Euro.

Nga kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë e datës 18.07.2018, rezulton se palët kontraktuese përkatësisht E.A., në cilësi të shitësit dhe S.M. , në cilësi të blerësit, kanë lidhur kontratë për shitblerjen e paluajtshmërisë në sipërfaqe prej 01.15, 00 ha, për ngastrat kadastrale P-01367-0 dhe P-01376, Zona Kadastrale .....

Nga certifikatat e paluajtshmerisë dhe kopjet e planit me numër 11-292-20219 dhe 11-268-2019 të datës 28.01.2019 dhe datës 24.01.2019 lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunës së Klinës, rezulton se parcela P-71010027-01349-9, evidentohet në emër të D.A., me sipërfaqe prej 500 m2, si dhe parcela me numër P-71010027-01371-0 në sipërfaqe prej 1829 m2, evidentohet në emër të D.A..

Nga historiat i paluajtshmerive me numër 761, 765/2022 i datës 17.03.2022, rezulton se njësitë kadastrale me numër 1365-0 në sipërfaqe prej 0.10.25 ha, 1366-1 në sipërfaqe prej 0.08.56 ha, nr. 1366-2, në sipërfaqe prej 0.00.99 ha, nr.1367-0 në sipërfaqe prej 0.16.79 ha, sipas kontratës së shitblerjes me numër të referencës 145/2019 të datës 28.01.2019 nga zyra noteriale në Klinë, prej shitësit I.A.A., ka kaluar në emër të N. S.M. .

Nga aktvendimi mbi regjistrimin e hipotekës me numër protokollit 440/2017 i datës 14.06.2017, rezulton se Zyra Komunale e Kadastrit në Klinë, sipas kërkesës së BKT, ka marrë aktvendim mbi regjistrimin e hipotekës për patundshmërinë e evidentuara në emër të D.A., N.T.T. “.....”.

Nga certifikata e patundshmërisë e datës 22.03.2022 lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunës së Klinës, rezulton se në emër të biznesit individual N.T.T. “.....”, kanë qenë disa parcela kadastrale dhe tre nga këto parcela kanë qenë nën hipotekë, përkatësisht njëra në PCB dhe dy të tjera në NLB Bank.

Nga tre historiatet e paluajtshmerive me numër 101/2022 të datës 14.01.2022 të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, rezulton se nga Komuna e Klinës, Drejtoria për

Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi është dhënë historiat për ngastrat kadastrale në ZK ....., të cilat paraprakisht kanë qenë në emër të personave të tjerë e që më pas kanë kaluar në emër të D.A..

Nga njoftimi për shitjen/qiradhënien e aseteve të bankës, rezulton se institucioni bankar BKT, i ka shpall në shitje parcelat me numër P-71010027-01362-0, P-71010027-01363-1, P-71010027-01363-2, P-71010027-01363-4.

Nga propozimi për përmbarim me numër protokollit 45061 i datës 10.04.2019, rezulton se BKT, ka parashtruar propozim ndaj debitorëve N.T.T. “.....”, D.A. dhe B.A. , për borxhin në shumë prej 210,635.37 Euro.

Ndërsa sa i përket deklaratës së ekspertit A.B., dhënë në PTHDKR në Pejë, e datës 23 mars 2022, e cila është propozuar që të administrohet si provë, gjykata nuk i është referuar të njëjtës pas parasysh se sipas po këtij procesverbalit. është gjetur se deklarata e ekspertit është marrë pa u njoftuar palët lidhur me marrjen e kësaj deklarate në kundërshtim me nenin 129 të KPPRK-së.

Nga urdhri i përmbaruesit privat Zija Bala me numër P.nr.194/19, rezulton se me datë 19.07.2019, është dhënë urdhri për shitje të patundshmërive të debitorit D.A. dhe N.T.T. “.....”, janë urdhëruar debitorët dhe të gjithë mbajtësit e tjerë që kanë të regjistruar ndonjë kërkesë që kreditorit t’ia lirojnë patundshmëritë, e po ashtu është urdhëruar dhe Drejtoria Komunale për Kadastër dhe Gjeodezi në Komunën e Klinës, që të bëjë fshirjen e të drejtave të pronësisë nga debitori D.A. dhe N.T.T. “.....”, të regjistrojë si pronar BKT.

Nga konkluzioni i përmbaruesit privat me numër P.nr.194/19, rezulton se përmbaruesi privat Zija Bala, me datë 19.07.2019, ka lëshuar konkluzion me të cilin palujtshnëritë e D.A. dhe N.T.T. “.....”, i janë caktuar kreditorit Bankës Kombëtare Tregtare (BKT) me seli në Prishtinë.

Nga deklarata e datës 13.12.2012, rezulton se D.A., si pronar dhe drejtor i N.T.T. “.....” me seli në Klinë, i ka dhënë autorizim gjeneral E.A.-vëllai të tij. Me këtë deklarata i njëjti të gjitha të drejtat dhe detyrimet i ka bartur tek E.A. përkatësisht të drejtën e përfaqësimit si brenda dhe jashtë territorit të Kosovës, pa të drejtë kufizimi, si nënshkrimin e të gjithë dokumentacionit përkatës në emër të tij.

Nga autorizimi gjeneral i datës 25.07.2012, rezulton se E.A., është autorizuar nga D.A., që në emrin e tij, si dhe për interesin e tij, si shitës të lidhë kontratë të shitblerjes me blerësit e mundshëm apo të autorizuarit e tyre për shitblerjen e patundshmërive që gjenden në fshatin ....., Komuna Klinë, përkatësisht për 32 njësi kadastrale. Ky autorizim është vërtetuar në gjykatë.

Nga shkresa e Agjencisë Kosovare të Biznesit e nxjerr nga faqja e internetit me datë 09.02.2023, rezulton se N.T.T. “.....”, është biznes individual, si person i autorizuar është D.A., ndërsa drejtor E.A..

Nga kontrata me numër rendor LRP.nr.3985/2017, e datës 21.07.2017, rezulton se M. R. dhe M. R. , në cilësi të shitësve, ndërsa N.T.T. “.....” në cilësi të blerësit me pronar D.A., ndërsa përfaqësues E.A., kanë lidhur kontratë për shitblerjen e patundshmërisë me numër P-71010027-01375-1 Zona Kadastrale ....., me sipërfaqe prej 1921 m2 dhe P-71010027-01381-1 Zona Kadastrale ....., me sipërfaqe prej 305 m2.

Nga kontrata me numër LRP.nr.4015/2017, e datës 24.07.2017, rezulton se R.Q., V.Q., B.Q., M.Q., në cilësi të shitësve, kanë lidhur kontratë me N.T.T. “.....”, me pronar D.A., i përfaqësuar nga E.A., në cilësi të blerësve për patundshmërinë me numër P-71010027-01376-0, me sipërfaqe prej 1824 m2.

Nga kontrata me numër LRP.nr.4027/2017, e datës 24.07.2017, rezulton se R.I., të cilën e ka përfaqësuar M. R. , në cilësi të shitëses, ka lidhur kontratë me N.T.T. “.....”, me pronar D.A., të cilin e ka përfaqësuar E.A., në cilësi të blerësit, për patundshmërinë me numër P-71010027-01367-0 Zona Kadastrale ....., me sipërfaqe prej 1679 m2.

Nga certifikatat e pronës me numër P-71010027-01375-1, P-71010027-01381-1, rezulton se këto patundshmëri kanë qenë në emër të N.T.T. “.....”, ndërsa patundshmëria me numër P-71010027-01376-0, në emër të H.A..

Nga pëlqim me numër LRP.nr.1269/2015, 15.04.2015, rezulton se nga E. A., është dhënë pëlqimi me autorizim me të cilin e ka autorizuar bashkëshortin e saj D.A., të shes cilëndo patundshmëri e cila evidentohet në emrin e tij personal si dhe në emrin e biznesit të tij N.T.T. “.....”, me seli në Klinë, pa pëlqim tjetër nga ana e saj.

Nga parashtrësja e BKT e datës 27 tetor 2020, rezulton se ky institucion bankar i është përgjigjur disa pyetjeve të PTHDKR, sipas të cilave është dhënë sqarimi se kredimarrës ka qenë N.T.T. “.....”, me pronar D.A., i përfaqësuar nga B.A. dhe garantues kanë qenë D.A. dhe B.A. . Tutje kanë paraqitur një tabelë se si janë transferuar të hollat e kredisë, si dhe pronat që janë lënë peng për limitin kreditor. Këstet e kredisë janë realizuar në shumë prej 70,587.79 Euro dhe pagesa dërmuese janë bërë nga E.A., pjesërisht deponime ka pasur edhe nga Q. B., F.H., si dhe pagesa për shërbime transporti të pranuar në llogari. Nga janari i vitit 2019, ka pasur ngecje të pagimit të kësteve të kredisë dhe si pasojë e kësaj përmes procedurës përbarimore pronat të cilat e kanë siguruar kredinë kanë kaluar në pronësi të bankës.

Nga mendimi i përpiluar nga përfaqësues të Odes së Noterëve të Kosovës numër të referencës 4/22 i datës 24.01.2022, rezulton se bazuar në disa pyetje të parashtruar nga PTHDKR në Pejë, është dhënë mendimi se noteri më kërkesë të palës dhe në rrethana të caktuara mund të përgatitë paraprakisht autorizimin në formë të draftit, duke përfshirë të gjitha të dhënat e kërkuara si për palët ashtu edhe për përmbajtjen e autorizimit, me kusht që pas identifikimit të palës dhe leximit të bërë nga ana e noterit, përmbajtja e këtij autorizimi mbetet të pranohet apo jo nga vetë pala autorizimdhënëse. Përfundimisht sipas legjislacionit tonë në raste të caktuara, të arsyeshme dhe gjithmonë me kërkesë të palës kërkojnë nga noteri që nënshkrimet të merren edhe jashtë zyrës noteriale, krejt kjo me qëllim të ofrimit të shërbimeve noteriale edhe për ata qytetarë të cilët për shkaqe shëndetësore dhe shkaqe tjera të arsyeshme dhe të bazuara, si në rastin konkret-pamundësisë së daljes nga shtëpia me vendim të gjykatës dhe për shkaqe të hasmërisë ekzistuese si pasojë e vrasjes së mëhershme, konsiderohen fakte të arsyeshme që nënshkrimi të merret jashtë zyrës noteriale, ashtu siç dhe e kanë mashtruar noterin, me deklaram të rrejshëm se pala nuk ka mundësi të del nga shtëpia dhe të jetë prezent në zyrën noteriale. Tutje është thënë se shërbimet noteriale parimisht kryhen në zyre noteriale të noterit, por përjashtimisht sikurse edhe në procedura para organeve tjera, aktet noteriale pra edhe nënshkrimi jashtë zyrës mund të kryhet jashtë zyrës noteriale. Ajo do të duhej të merrej nga vet noteri, e të cilin mund ta asistojë edhe punëtori apo praktikanti i zyrës. Tutje është thënë se në rastin konkret noteri ka vepruar në mirëbesim duke e dërguar punëtorin e zyrës për nënshkrim, i bindur se të gjithë punën rreth identitetit të palës dhe rreth përmbajtjes së aktit e ka përfunduar më parë në zyrë dhe se pasi vet pala do të lexoj paraprakisht dhe pastaj edhe në shenjë pranimit të përmbajtjes do ta nënshkruaj personalisht dhe se nuk do të ketë pasojë juridike nga një akt i tillë noterial. Sa i përket procesverbal noterial, është thënë se Ligji për Noterinë në mënyrë shprehimore e ka paraparë se kur noteri duhet të hartoj procesverbal gjatë punës jashtë zyrës, ndërsa në praktikë procesverbali.



aplikohet në raste kur me kërkesë të palës, noteri del jashtë zyrës për të vërtetuar ekzistimin e një fakti e të cilin fakt ai e përshkruan në vendin e ngjarjes me procesverbal bazuar në shikimin e bërë drejtpërdrejtë, ndërsa në rastin konkret tek marrja e nënshkrimit nga pala, noteri të gjithë punën e tij tani e ka përfunduar në zyrën e tij bazuar në të gjitha të dhënat dhe shënime të cilat noteri iu kanë prezantuar dhe bazuar në këto shënime edhe është hartuar autorizimi në fjalë, pra akti është kompletuar i tëri në zyrën e tij, pa pasur nevojë për çfarëdo plotësimi eventual në teren dhe jashtë zyrës kërkohet vetëm nënshkrimi nga autorizim-dhënësi në aktin tani të kompletuar, andaj dhe kanë konsideruar se procesverbali në rastin konkret nuk është parë i domosdoshëm, ashtu si në praktikë në këto raste të akteve veprojnë noterët. Lidhur me përgjegjësinë e të akuzuarit B., është dhënë mendimi se noteri është mashtruar me dashje nga vëllai i autorizim marrësit dhe se qëllimi e as dashja e noterit nuk ka qenë për ta ndihmuar autorizim marrësin e as për ta dëmtuar vëllain e tij, në emër të cilit ka kërkuar autorizimin e dyshuar nga fakti se noteri në mirëbesim edhe ka vepruar kur e ka dërguar punëtorin e vet për të marrë nënshkrimin e palës. Lëshimi i noterit është cilësuar eventualisht si shkelje disiplinore.

### Mbrojtja e të akuzuarve

I akuzuari B. G., në mbrojtjen e tij dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 21 mars 2024, mes tjerash ka thënë se fillimisht ka punuar si gjyqtar, me pas avokat dhe nga viti 2014 e ushtron profesionin e noterit. Të akuzuarit E.A., B.A. , të dëmtuarin D.A., i njeh, ndërsa të akuzuarin B.G. e ka djalë të vëllait.

I kujtohet që në zyrën e tij ka shkuar i akuzuari E., datën nuk e di, por që sipas tij ka qenë një ditë para datës së autorizimit i cili konsiderohet si i falsifikuar. Atë ditë i akuzuari E., ka kërkuar nga ai që të përpilojë një autorizim gjeneral për pronat dhe biznesin në emër të vëllait të tij D.A., i cili në atë kohë ndodhej në vuajtje të dënimit, mirëpo sipas të akuzuarit E. nga Qendra Korrektuese në Dubravë, ishte lëshuar për pushim në vikend dhe i njëjti nuk mund të vije personalisht në zyre për shkak të gjakmarrjes. Duke pasur besim tek E.u dhe tek vëllezërit tjerë, të cilit kishin raporte të mira në mes vete, e po ashtu marrë parasysh se të njëjtit kanë përpiluar autorizime të tilla edhe me parë, e dërgon punëtorin e tij këtu të akuzuarin B.G., që të shkojë në shtëpinë e të dëmtuarit D.A., për të nënshkruar atë autorizimin, meqë sipas ligjit nuk është e ndaluar dhe pasi B. kthehet në zyre dhe i konfirmon se gjithçka ishte në rregull, ndërmerr veprime tjera bazuar në këtë autorizim.

Pas pak kohësh, me saktë në fund të muajit gusht të vitit 2019, këtu i dëmtuari D., kërkon që t'ia dërgoj një kopje të autorizimit dhe meqë ishte vikend dhe jashtë vendit, kopjen e autorizimit të nesërmen ia dërgon në aplikacionin “Viber”. Nga ai moment ndërprerën të gjitha veprimet që lidheshin me atë autorizim, pasi që këtu i dëmtuari i thotë se ai autorizim nuk është nënshkruar nga ai.

Ligjin për Noterinë pohoj se e njeh, mirëpo rrethanën se nuk e kishte konstatuar në autorizim se vërtetimi i nënshkrimit po bëhet jashtë zyrës noteriale tha se ka qenë gabim teknik. Të gjitha aktet noteriale duke përfshirë dhe faturat tha se i nënshkruan personalisht, ndërsa kontratat për shitblerje të veturave dhe hipotekë ekzistojnë raste kur përpilohen nga stafi, por nënshkruhen nga ai si noter edhe përkundër se në shumicën e rasteve i ka përpiluar vetë ai.

I akuzuari B.G., në mbrojtjen e tij dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 27 maj 2024 mes tjerash ka thënë se që nga viti 2014-2015, punon në zyrën noteriale tek noteri B. G., si asistent noterial.

Me datë 13.06.2017, i kujtohet që noteri i kishte thënë që të shkojë në fshatin ....., Komuna Klinë, për të marrë një nënshkrim në shtëpinë e këtu të dëmtuarit D.A., për shkak të pamundësisë së tij të shkojë në zyre, ngase ishte në gjakmarrje. Paraprakisht e kishte marrë dokumentin identifikues të D.t, certifikatën e biznesit dhe se bashku me E.A. apo Q. B., nuk e di saktë, kanë shkuar tek shtëpia e D.t.

Gjatë rrugës sa ishin duke shkuar tek shtëpia e të dëmtuarit, tha se kanë biseduar për shkak të pamundësisë së tij për të shkuar në zyre noteriale për nënshkrim dhe me të arritur tek shtëpia e D.t, personi që ishte me të hynë brenda për ta thirre. Pasi D. del, autorizimin e nënshkruan në korridor të shtëpisë, gjersa ai ndodhej jashtë shtëpisë dhe me të filluar ta lexojë autorizimin, ndërprehet me arsyetimin se nuk është nevoja të lexohet, pasi e din se për çfarë do të ipet autorizim.

Pas marrjes së nënshkrimit e di që është kthyer në zyre dhe i ka konfirmuar noterit se nënshkrimi është dhënë nga D., meqë nuk kishte dyshime, pas parasysh dhe rrethanat e gjakmarrjes dhe faktin se aty ishin prezent dhe familjarët tjerë.

Tutje tha se S. dhe D., nuk i ka njohur dhe kurrë me parë nuk i ka parë dhe problemet që kanë lind nga ky nënshkrim e ka kuptuar vetëm pasi është ftuar nga policia.

Ai shtoj se edhe përkundër se nuk e ka të përfunduar Fakultetin Juridik, i di rastet se kur mund të bëhet nënshkrimi jashtë zyrës dhe me sa është në dijeni lejohet që asistenti të shkojë për të marrë nënshkrim jashtë zyrës, e kjo mënyrë aplikohet edhe nga noterët tjerë.

Ka mohuar në mënyrë kategorike se ka pasur ndonjë marrëveshje apo iu ka ndihmuar të akuzuarve B., E. dhe B., për kryerjen e veprës penale të falsifikimit të dokumentit zyrtar.

I akuzuari B.A., në mbrojtjen e tij dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 27 maj 2024, mes tjerash ka thënë se jeton në fshatin Shtupel, Komuna Klinë dhe merret me bujqësi.

I kujtohet se derisa ishte në shtëpinë e tij, nga vëllai i tij E.a, i është kërkuar që të shkojë në fshatin ....., Komuna Klinë, ku i kanë shtëpitë vëllezërit e tij, me saktësisht tek shtëpia e M..

Me t'u takuar, vëllezërit e tij D.a, M. dhe E.a, i thonë se duhet të shkojë tek noteri për me bartë shtëpinë në emër të M., e di që atë ditë është nënshkruar dhe autorizimi e po ashtu i kujtohet që D.a, i është drejtuar M., se krejt dokumentet janë gati tek noteri, veç shko për nënshkrim. Kjo kohë tha se ishte kur D.a, ka qenë në burg dhe pas një apo dy dite, kanë shkuar në BKT për të nënshkruar marrjen e një kredie në emër të firmës N.T.T. "...", sipas E.së ajo ka qenë për nxjerrjen e D.së nga burgu. Të hollat e kredisë tha se nuk i ka marrë dhe me rastin e kredisë nuk është pyetur për D.n.

Ka mohuar të ketë qenë prezent në kohën kur këtu i akuzuari B.G., ka qenë për nënshkrim tek vëllezërit e tij dhe po ashtu se ka pasur marrëveshje me ndonjërin nga të akuzuarit për falsifikim të autorizimit apo se ka qenë në dijeni se ai autorizim është i falsifikuar.

Në fund ka shtuar se vëllai të tij këtu të akuzuarit E., i ka besuar për çdo gjë, përfshirë dhe rrethanën se autorizimi ishte nënshkruar nga D. dhe gjithnjë ka vepruar siç ka thënë ai.

Për autorizimin e falsifikuar e ka kuptuar pasi D. është kthyer nga Italia dhe aty e ka kuptuar se të gjitha vetë i ka bërë E.a.

I akuzuari E.A., në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 27 maj 2024, mes tjerash tha se të akuzuarin B. e ka njohur si noter, pasi është marrë me shitblerje, por raporte shoqërore me të nuk ka pasur.

I kujtohet se ka pasur autorizimin e datës 25.07.2012, i vërtetuar në gjykatë, për të gjitha pronat, përkatësisht për shitjen dhe vënien e tyre në hipotekë si dhe e ka pasur një kredi në emër të biznesit N.T.T. “.....”, në ProCredit Bank. Me rastin e marrjes së kësaj kredie, të gjitha pronat që i posedonin ai me vëllezër janë lënë në hipotekë.

Me vonë e kupton se në BKT, është kamata më e vogël dhe meqë ishte garantues për një person tjetër dhe i është prishë historia, menaxheri i bankës e këshillon që ai personalisht të mos aplikojë për kredi, pasi që mund t’i refuzohet për shkak të historisë. Në këtë rast, me qëllim që të fillojë me procedura për marrje të kredisë, vendos që të bëjë një autorizim gjeneral me të cilin vëllai i tij D.a, i cili ishte në burg e autorizon vëllain tjetër këtu të akuzuarin B., për shitjen e të gjitha patundshmërive të evidentuara në emër të biznesit N.T.T. “.....”.

Me pas, shkon tek noteri B. dhe me dokumente të dy vëllezërve si dhe dokumentacion të parcelave, kërkon nga ai që të përpilojë këtë autorizim për vëllain e tij D.n, për shkak të pamundësisë së tij për të shkuar në zyre noteriale si pasojë e gjakmarrjes. I akuzuari B., përgatitë autorizimin dhe për vërtetim të nënshkrimit e dërgon punëtorin e tij këtu të akuzuarin B..

Pasi punëtori i noterit, këtu i akuzuari B., arrin tek shtëpia e tij, i akuzuari me qëllim që ta vë në lajthim, kërkon nga ai që t’ia jep autorizimin që D. të nënshkruhet brenda shtëpisë, me arsyetimin se kanë shumë mysafirë që kishin shkuar për ta parë dhe pasi merr autorizimin kinse për ta nënshkruar D.a, pa prezencën e të akuzuarit B., kërkon nga i akuzuari S., që të nënshkruaj këtë autorizim, duke i thënë se ai nënshkrim ka të bëjë për lirimin me kusht të të dëmtuarit D..

Pasi përfundon procedurën me autorizim, arrin ta marrë kredinë në vlerë prej 250.000 Euro dhe vlerën e të hollave prej 100.000 Euro, e deponon në PCB, me qëllim të lirimit të hipotekave, 24.000 Euro për angazhim të avokatëve në çështjen e të dëmtuarit D. dhe pjesën tjetër për blerjen e katër pronave në emër të N.T.T. “.....”. Disa nga këto prona i ka shitur, por ka ende që figurojnë në emër të biznesit.

Sa i përket pronës së N. M., përkatësisht pronës së motrës së tij, ai mohoj se ajo pronë është shitur, sipas tij ajo është lënë peng deri në marrjen e një prone tjetër.

Me BKT, tha se kishte komunikuar vetëm ai, pasi menaxheri i bankës S. M., ka punuar fillimisht në PCB, e me pas ka kaluar në BKT.

Ka mohuar të ketë pasur ndonjë marrëveshje me të akuzuarit, duke thënë se të gjithë janë viktimë të tij, ndërsa ai është viktimë e këtu të dëmtuarit D., pasi që ai ka qenë në dijeni për të gjitha veprimet e tij dhe se të gjitha këto i ka bërë për të, përfshirë dhe marrjen e kredisë në vlerë prej 240.000 Euro.

I akuzuari S.K., në shqyrtim gjyqësor ka shfrytëzuar të drejtën e heshtjes.

Ndërsa në deklaratën e tij dhënë në prokurori me datë 20 janar 2021, mes tjerash ka thënë se me familjen A., ka raporte miqësore, përkatësisht motra e tij është e martuar me B.A. dhe vëllai i tij S., është i martuar me motrën e vëllezërve A.. Ndërsa të akuzuarit B. dhe B.G., nuk i njeh.

Ai tha se me datë 13.06.2017, ku pretendohet se është kryer vepra penale, ka qenë duke e bërë krasitjen e gjelbërt dhe mbrojtjen e pemëve dhe atë natë ka qëndruar tek i akuzuari E.A., pasi që ishte duke punuar. I kujtohet që ka konsumuar alkool dhe derisa ishte nën ndikim të alkoolit nga i akuzuari E., i është ofruar një autorizim për nënshkrim dhe pa e lexuar është nënshkruar, pasi që E.a i kishte thënë që ka qenë për vëllain e tij në burg këtu të dëmtuarin D.A..

Në fund ka thënë se i akuzuari E. e ka vë në lajthim, pasi që në momentin e nënshkrimit nuk ka qenë në gjendje të kontrolloj veprimet e veta si rrjedhojë e konsumimit të alkoolit.

### Fjala përfundimtare

Prokurorja e Shtetit Sahide Gashi, në fjalën përfundimtare të dorëzuar në formë të shkruar në mes tjerash tha se gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se të akuzuarit B. G., B.G., B.A. , E.A. dhe S.K., kanë kryer veprat penale sipas aktakuzës.

Këto pretendime tha se janë vërtetuar nga dëgjimi i të dëmtuarve në cilësi të dëshmitarëve, përkatësisht të D.A., M. A., H.A., Xh. dhe M. B., N. e S.M. , të cilët dëshmuar se asnjëri nga ta

nuk ka qenë në dijeni për lenie të pronave të tyre në hipotekë apo se ato u janë shitur personave tjerë nga ana e të akuzuarit E. dhe B., e me ndihmën e të akuzuarve tjerë, përmes një autorizimi të falsifikuar.

Përveç këtyre dëshmitarëve, është dëgjuar dhe E. A., e propozuar nga i akuzuari B., e cila me deklaratën e saj vërtetoi se nga E.u i është bërë presion që të shkojë në zyrën noteriale të të akuzuarit B., kinse për shkak se i duhet të nënshkruaj për të shitur një autobus dhe se nga noteri B., nuk i ishte komunikuar arsyeja e dhënies së pëlqimi.

Se autorizimi gjeneral nuk ka qenë dashur të nënshkruhet nga palët pa prezencën e drejtpërdrejtë të vet noterit, këtë më së miri e ka sqaruar anëtari i Ekspertit të Komisionit të Odës së Noterëve të Kosovës Sh. H., i cili përveç kësaj tha se noteri duhet edhe t'iu lexojë palëve dhe të kujdeset që ato e kanë të qartë se për çfarë bëhet fjalë.

Tutje, prokuroria në fjalën e saj përfundimtare ka cituar përmbajtjen e provave materiale në të cilat e ka mbështetur aktakuzën, si dhe mbrojtjen e të akuzuarve, duke pretenduar se mbrojtja e të akuzuarve ishte në kundërshtim me të gjitha dëshmitë personale dhe provat materiale, por edhe me deklaratimet e njëri tjetrit.

Në vazhdim të fjalës përfundimtare janë dhënë konstatimet përfundimtare, sipas të cilës rrjedh se mbi bazën e provave materiale e personale, nuk është kontestuese se i akuzuari B. G., pa prezencën e të dëmtuarit D.A., ka përpiluar autorizimin gjeneral LRP.nr.307/2017 i datës 13.06.2017; Se autorizimi në marrëveshje me të akuzuarin E.A., është nënshkruar jashtë zyrës noteriale të të njëjtit dhe kjo nuk është konstatuar në këtë autorizim; Se në kundërshtim me nenet 33, 38 e 45 par.1 e 2 të Ligjit mbi Noterinë Nr.0/L-010 si dhe Udhëzimin Administrativ Nr.02/2012, autorizimet e veta i ka bartë tek personi tjetër, këtu i akuzuari B.G.; Se me të akuzuarin E.A., janë njohur gjatë, qysh para luftës dhe ka kryer shërbime të ndryshme si avokat, mbrojtës e noter, por edhe me të dëmtuarin D.A.; Se në realitet përpilimi dhe nënshkrimi i këtij autorizimi është bërë jo në fundjavë apo vikend, por në ditë pune; Është notore se të burgosurit lëshohen ditëve të vikendit për pushim e jo ditëve të punës, e nga të cilat rrjedh se në këtë mënyrë i akuzuari B., nuk i ka përmbushur me dashje e vetëdije detyrat zyrtare e me dashje iu ka mundësuar falsifikimin e autorizimit në fjalë si dokument zyrtar të akuzuarve S.K., nëpërmjet të akuzuarit E.A., në marrëveshje me të akuzuarin B.A. , e përmes të akuzuarit B.G..

Sa i përket pretendimit se i akuzuari E.A., e ka vënë në lajthim të akuzuarin B. G., prokuroria konsideron se nuk mund të marrin të mirëqenë, pas parasysh se të gjitha veprimet që i ka ndërmarrë apo nuk i ka ndërmarrë, janë në kundërshtim të plotë me detyrat e veta. Fakti që E.un e ka njohur gjatë, rrjedhimisht edhe precedentët e tij penale, faktin se ka qenë në dijeni se i dëmtuari është në vuajtje të dënimit me burgim dhe nuk kërkuar asnjë dëshmi se i njëjti gjendet në lirim për vikend, nuk e konstaton fare në dokumentin zyrtar se nënshkrimi i tij bëhet jashtë zyrës së noterisë, e pastaj e dërgon një praktikant për t'ia marrë kinse nënshkrimin e personit që ai fare nuk e njihte, janë rrethana të qarta se e gjithë kjo ka ndodhur në marrëveshje të plotë në mes tij dhe E.A.. Kryerprokurorë

Mbi bazën e këtyre rrethanave, ka propozuar që konform nenit 458 të KPPRK-së, të anulohen veprimet juridike, përkatësisht kontrata mbi kredinë bankare me numër 8206/17 e datës 13.06.2017, kontrata mbi hipotekën me numër LRP.nr.3122/2-17 dhe ref.nr.838/2017 e datës 13.06.2017, marrëveshja mbi pengun numër 8206/17 e datës 13.06.2017, kontrata mbi shitblerjen e patundshmërisë me numër LRP.nr.641/2019 dhe ref.nr.144/2019 e datës 28.01.2019, si dhe kontrata mbi shitblerjen e palujtshmërisë e datës 18.07.2018 e lidhur në mes të akuzuari E. si shitës dhe në anën tjetër të babait të të dëmtuarit N., S.M. tek avokati Isa Gashi, me të cilat janë transferuar patundshmëritë e të dëmtuarit D.A. dhe të dëmtarëve tjerë që janë në posedim faktik të tyre, që kanë qenë objekt i masës së përkohshme për sigurimin e pasurisë të shqiptuar nga ana e Gjykatës Themelore në Pejë, me aktvendimin DKR.PP.nr.135/20 në pajtim me nenin 467 par.1 lidhur me nenin 459 dhe 469 të KPPRK-së, pasi që janë rezultat i veprave penale sipas aktakuzës.

Mbi bazën e të cekurave me lartë, ka propozuar që të akuzuarit të shpallën fajtor, të dënohen sipas ligjit si dhe të obligohen në kompensimin e dëmit të dëmtuarve dhe pagimin e shpenzimeve të procedurës penale.

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit E.A., av.Bujar Bërdynaj, fillimisht e ka mbështetur fjalën përfundimtare të prokurores së shtetit, ndërsa në fjalën e tij përfundimtare të dorëzuar në formë të shkruar, ka theksuar se nga provat materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se të akuzuarit kryer veprat penale sipas aktakuzës.

Pretendimet e aktakuzës tha se janë vërtetuar nga dëgjimi i përfaqësuesit të Odës së Noterëve të Kosovës Sh. H., në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 21.03.2024, i cili ka sqaruar se

përpilimin e akteve noteriale mund ta bëjë bashkëpunëtori apo i punësuar në zyrën noteriale, mirëpo noteri duhet të jetë prezent me rastin e dhënies së nënshkrimit dhe se në raste kur personat janë të palëvizshëm apo për arsyeje tjera nuk mund të paraqiten tek zyra e noterit, asistenti mund të shkoj të vërtetojë identitetin e atij personi që është kërkuar marrja e nënshkrimit jashtë zyrës, mirëpo ai kthehet i tregon noterit dhe më pas noteri shkon dhe e merr atë nënshkrim dhe se në këto raste përpilohet procesverbal noterial.

Referuar këtyre rrethanave, pretendon se është vërtetuar se vet noteri B., e kishte dërguar punëtorin B.G., në fshatin .....për të marrë nënshkrimin nga D.A. edhe pse nuk kishte të drejtë sipas Ligjit për Noterinë dhe si rrjedhojë e këtij veprimi i është mundësuar të akuzuarit S.K., të nënshkruhet në vend të dëmtuarit D.A., dhe me këtë autorizim të falsifikuar, është marrë kredi në BKT në shumë prej 250.000 Euro, duke lënë në hipotekë palujtshmëritë që ishin në emër të D.A., por të njëjtat palujtshmëri nuk ishin të tij, por të vëllezërve dhe të motrave të cilat gjenden në botën e jashtme.

Bazuar në të lartcekurat, i ka propozuar gjykatës që të akuzuarit B. G., B.G., E.A., B.A. dhe S.K., t'i shpall fajtor për veprat për të cilat akuzohen, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat në lidhje me motivin dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale, t'iu shqiptojë një dënim maksimal me burgim, i cili do të jetë në harmoni dhe proporcion me natyrën, peshën, motivet dhe mënyrën e kryerjes së këtyre veprave penale, si dhe të anulohen të gjitha veprimet të cilat janë marrë sipas autorizimit të falsifikuar dhe të gjitha palujtshmëritë t'i kthehen në pronësi të të dëmtuarit D.A., i cili më pas do t'iu bartë të dëmtuarve tjerë.

I dëmtuari D.A., e ka mbështetur në tërësi fjalën përfundimtare të përfaqësuesit të tij, duke propozuar që të anulohen të gjitha kontratat mbi shitblerjen dhe të kthehen pronat në emër të tij.

Përfaqësuesi i autorizuari i të dëmtuarës BKT, I.S., në fjalë përfundimtare ka thënë se në rast se vërtetohet se të akuzuarit kanë kryer veprat penale sipas aktakuzës dhe pronat kthehen në gjendje të mëparshme, ka propozuar që gjykata konform të dispozitës së nenit 462 të KPPRK-së, t'i detyroj të gjithë të akuzuarit të kompensojë dëmin të dëmtuarës BKT.

Mbrojtësi i të akuzuarit B. G., av.Gëzim Baloku, në fjalën përfundimtare ka theksuar se gjatë shqyrtimit gjyqësor me asnjë provë nuk u vërtetua se i akuzuari B., ka kryer veprat penale sipas aktakuzës.



Sipas aktakuzës veprat penale janë kryer me marrëveshje me të akuzuarit tjerë, mirëpo gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk u vërtetua se i akuzuari B., ka pasur ndonjë marrëveshje gojarisht apo me shkrim me të akuzuarit tjerë.

Se i akuzuari B., nuk e ka kryer veprën penale kjo vërtetohet edhe me Mendimin e Odës së Noterëve i dhënë me datës 24.01.2022, ku është thënë se në këtë rast është dashur që autorizimi të bëhet jashtë zyrës, pasi kanë ekzistuar rrethana që e lejojnë këtë dhe se noteri dhe punëtori i tij kanë qenë të mashtruar nga pala dhe në fund është thënë se lëshimet e noterit sipas tyre mund të cilësohen shkelje disiplinore.

I akuzuari B. G., nuk ka pasur dashje për të kryer vepër penale dhe rrjedhimisht kur nuk ka dashje nuk ka vepër penale. I dëmtuari D.A., nuk është i dëmtuar, kjo pas parasysh se me deklaratën e datës 13.12.2012, ia ka lënë të gjitha kompetencat vëllai të tij këtu të akuzuarit E.A., ndërsa me autorizimin e datës 25.07.2012, ka dhënë autorizim në kohë të pakufizuar, çka do të thotë se ai ka qenë i vetëdijshëm për veprimet që i ka ndërmarra.

Tutje, tha se nuk duhet falur besimi deklaratës së Sh. H., pasi që deklarimi i tij është në kundërshtim me mendimin e dhënë si anëtar i Odës së Noterëve.

Bazuar në të lartcekurat, ka propozuar që i akuzuari B. G., të lirohet nga akuza, marrë parasysh dhe faktin se për 15 vite noter, asnjëherë nuk ka pasur asnjë vërejtje dhe asnjëherë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale.

I akuzuari B. G., e ka mbështetur në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij duke thënë se prokuroria me asnjë provë nuk i ka provuar pretendimet e akuzës, marrë parasysh dhe faktin se edhe vetë të akuzuarit E. dhe B., kanë thënë se nuk kanë pasur marrëveshje me të, apo me dikë tjetër që në dobi të tyre apo të tjerëve të kryejnë ndonjë vepër penale. Po ashtu ka shtuar se autorizimet e D.A., të cilat ia ka dhënë vëllait të tij E.ut, kanë qenë në fuqi deri me 08.10.2019, kur këtu i dëmtuari D., ka bërë revokimin e tij. Bazuar në të lartcekurat dhe në mungesë të provave, ka propozuar që të lirohet nga akuza.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.G., av. Ardian Deskaj, në fjalën përfundimtare të dorëzuar në formë të shkruar ka theksuar se gjatë shqyrtimit gjyqësor me asnjë provë nuk është vërtetuar se i njëjti ka kryer veprat penale sipas aktakuzës.

Për tu konsideruar se është kryer vepra penale e falsifikimit të dokumentit zyrtar nga neni 434 par.1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, duhet të vërtetohet se vepra është kryer me dashje, çka do të thotë se kjo veprë nuk është e inkriminuar kur kryhet nga pakujdesia.

Veprimet e të akuzuarit B., sipas mbrojtjes mund të kualifikohen si lajthim në fakte edhe përkundër se lajthimi në fakte ekziston kur e gabon personin apo gabon ndonjë fakt, mirëpo në rastin konkret B.G., është shtyrë nga të tjerët që të gaboj.

Mbrojtja tutje ka pretenduar se i akuzuari B. por dhe i akuzuari B., janë viktimë të veprës penale të mashtrimit të kryer nga i akuzuari E.A., këtë e ka mbështetur dhe në deklaratën e të dëmtuarit D.A., i cili mes tjerash me rastin e raportimit të rastit në polici e ka pohuar se vëllai i tij E.u, e ka prezantuar një person tjetër për nënshkrim.

Se i akuzuari B. nuk e ka kryer veprën penale, këtë e ka mbështetur dhe në faktin se sikur të ekzistonte dashja e të akuzuarit B. për falsifikim të autorizimit, ai nuk do të shkonte në fshatin ....., për nënshkrim të autorizimit, por nënshkrimi do të ishte bërë në zyre noteriale.

Se ishte mashtruar nga i akuzuari E.A., kjo vërtetohet nga vetë deklarata e këtij të akuzuarit, i cili tha se ka prezantuar fakte rrejshëm, duke thënë se vëllai i tij këtu i dëmtuari D., nuk mund të shkojë në zyre noteriale për nënshkrim, për shkak të frikës nga gjakmarrja dhe pasi asistenti i noterit B. këtu i akuzuari B., shkon në fshatin ....., i njëjti e prezanton një person tjetër si D.A..

Pafajësinë e të akuzuarit B., e mbështetë dhe në provat materiale, e ndër të tjera në mendimin nga Oda e Noterëve, në të cilën mes tjerash është thënë se lëshimi i noterit, mund të cilësohet eventualisht shkelje disiplinore, pasi noteri asistenti apo punëtori i tij kanë qenë të mashtruar.

Tutje mbrojtja pretendon se të dëmtuarit BKT, S. dhe N. M., D.dhe H.A., i kanë realizuar qëllimet e veta pasurore, dhe të njëjtit nuk duhet trajtuar si të dëmtuar.

Qëllimi i të akuzuarit B. por edhe të akuzuarit B., tha se ishte kryerja e punëve të cilat kanë qenë në kompetencë të tyre dhe nuk kanë pasur qëllim për ndërmarrjen e ndonjë veprimi inkriminues.

Në fund mbrojtja pretendon se prokuroria figurën dhe përshkrimin e veprave penale e ka bërë duke u bazuar në deklaratën e të akuzuarit E.A. dhe të akuzuarve tjerë dhe se i akuzuari B.G., në asnjë moment nuk ka qenë i përfshirë me dashje, pasi që i njëjti ka qenë i mashtruar, andaj dhe referuar këtyre rrethanave ka propozuar që i njëjtit të lirohet nga akuzat.

I akuzuari B.G., e ka mbështetur në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

Mbrojtësi i të akuzuarit E.A., av.Blerim Ademaj, në fjalën përfundimtare të dorëzuar në formë të shkruar, tha se gjatë shqyrtimit gjyqësor me rastin e dëgjimit të dëshmitarëve si dhe administrimit të provave materiale, nuk është vërtetuar se i akuzuari E., ka kryer veprat penale sipas aktakuzës.

Ai tutje në fjalë përfundimtare ka përshkruar format e kryerjes së kësaj vepre penale, duke pretenduar se i akuzuari në fjalë nuk ka përfituar, por të gjitha kreditë i ka marrë në emër dhe llogari të biznesit, për të cilin ka pasur autorizim të menaxhoj, e për të cilat veprime ka pasur njohuri të dëmtuari.

Po ashtu ka thënë se i mbrojturi i tij nuk është kryerës i veprës penale të falsifikimit të dokumentit zyrtar, pas parasysh se për t'u konsideruar se është kryer kjo vepër penale, personi duhet të jetë person zyrtar, e që në rastin konkret nuk e ka këtë cilësi.

Bazuar në të lartcekurat, i ka propozuar gjykatës që konform nenit 363 të KPPRK-së, të njëjtin ta liroj nga aktakuza.

I akuzuari E.A., e ka mbështetur në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, duke shtuar se të gjitha këto veprime i ka ndërmarrë për shkak të obligimeve të mëdha rrjedhimisht gjendjes së dobët ekonomike, në kohën kur vëllai i tij këtu i dëmtuari D.A., ka qenë në burg për shkak të një vepre penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.A. , av.Rrustem Lajqi, në fjalën përfundimtare të dorëzuar në formë të shkruar, ka thënë se me vetë provat e propozuara nga prokuroria u vërtetua pafajësia e të akuzuarit B..

Bazuar në përshkrimin faktik të veprës penale falsifikimit të dokumentit zyrtar por referuar edhe dispozitës ligjore nga neni 434 par.1 lidhur me 31 të KPRK-së, rezulton se vepra penale për të cilën është ngarkuar i akuzuari B., mund të kryhet vetëm nga personi i cili e ka cilësinë e personit zyrtar, e që në rastin konkret i akuzuari B., nuk hyn fare në atë kategori.

Përveç kësaj, përshkrimi faktik i kësaj pike të aktakuzë është i mangët dhe nuk përfshinë as edhe një provë të vetme e cila do të inkriminonte të akuzuarin në fjalë, pasi që për të kryer këtë vepër e ka objektivisht të pamundur, por as ndonjë vepër tjetër e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare.

Sa i përket veprës penale të mashtrimit nga neni 355 par.2 e 4 lidhur me par.1 si dhe nenin 31 dhe 81 të KPRK-së, prokuroria me asnjë provë nuk ka arritur të vërtetojë përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari B., ka kryer këtë vepër penale, pas parasyshe se i njëjti nuk ka pasur asnjë lloj përfitimi qoftë nga kredia e marrë apo pronat e blera, fakt ky i pakontestueshëm. Këtë rrethanë e ka vërtetuar edhe vetë i akuzuari E.A., i cili ka thënë se paratë nga kredia kanë dalë në xhirollogari të biznesit “.....”, e në këtë biznes nuk kishte pasur asnjëherë autorizim apo qasje i akuzuari B..

Se i akuzuari B., nuk e ka kryer veprën penale kjo vërtetohet edhe nga shkollimi tij, i cili ka të përfunduar vetëm klasën e katërt të shkollës fillore, çka do të thotë se nuk ka pasur njohuri mbi procedurat ligjore për dhënie të autorizimit dhe ka vepruar sipas instruksioneve të dhëna nga vëllai i tij, këtu i akuzuari E., i cili e ka vënë në lajthim.

Bazuar në të lartcekurat mbështetur dhe në parimin “in dubio pro reo”, ka propozuar që i akuzuari B.A. , të lirohet nga aktakuza, pasi që nuk është vërtetuar me asnjë provë se i njëjti ka kryer veprat penale për të cilat është ngarkuar.

I akuzuari B.A. , e ka mbështetur në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

Mbrojtësi i të akuzuarit S.K., av. Lulzim Balaj, në fjalën përfundimtare të dorëzuar në formë të shkruar ka thënë se edhe pas administrimit të provave të propozuara nga prokuroria nuk u vërtetua se i akuzuari S.K., e ka kryer veprën penale sipas aktakuzës.

Pafajësia e të akuzuarit ka thënë se vërtetohet nga deklaratat e të akuzuarit B.A., ku ka theksuar se S.K., nuk e ka ditur se çka është duke nënshkruar dhe se i njëjti është viktimë e tij. Prandaj, bazuar në këto rrethana i ka propozuar gjykatës që konform nenit 363 par.1, nënpar.1.3 të KPPRK-së, të njëjtin ta liroj nga akuza.

I akuzuari S.K. e ka mbështetur në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

### Pika I

Gjykata pas administrimit të provave në seancën e shqyrtimit kryesor, e në kuptim të nenit 360 par.2 të KPPRK-së, duke i vlerësuar me ndërgjegje çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, e në bazë të vlerësimit të tillë ka vërtetuar gjendjen faktike si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

PTHDKR në Pejë, të akuzuarin E.A., e ka ngarkuar për veprën penale të kryer në vazhdimësi *Mashtrim nga neni 355 par.2 lidhur me par.1 e nenin 81 të KPRK-së.*

I akuzuari E. ka mohuar kryerjen e veprës penale, duke thënë se ajo pronë është lënë peng deri në marrjen e një prone tjetër dhe se nuk i është shitur S. e N. M..

Mbrojtësi i të akuzuarit E.A., av. Blerim Ademaj, ka kundërshtuar pretendimin e aktakuzës duke thënë se i akuzuari E., nuk ka përfituar asgjë por të gjitha veprimet i ka ndërmarrë në emër dhe llogari të biznesit që e kanë pasur vëllezërit A..

Gjykata me rastin e administrimit të provave, me saktësisht dëgjimit të dëshmitarëve e në veçanti dëgjimit të të dëmtuarit D.A., ka vërtetuar se i akuzuari E.A., pa autorizimin e tij ia kishte shitur pronën S. e N. M. edhe përkundër se ajo më parë nga pronari juridik është shitur tek motra e tyre Xh. dhe dhëndri M. B. dhe të njëjtit në këtë pronë kanë ndërtuar shtëpinë, mirëpo nuk kanë qenë të regjistruar në kadastër si pronar.

Këto rrethana gjykata i ka vërtetuar edhe nga dëgjimi i dëshmitarit/dëmtuarit M. B., i cili vëllezërit A. tha se i ka miq dhe se në vitin 2010 nga këtu i dëmtuari D.A., ka blerë pronën në

sipërfaqe prej 5 ari, në fshatin ....., për të cilën dhe ia kishte bërë gjithë pagesën. Në atë pronë ka ndërtuar shtëpinë dhe ka qenë në posedim faktik të qetë, derisa një person i quajtur Q. B.jaj, në vitin 2019 e kishte njoftuar se E.u, ia kishte shitur pronën dhe me rastin e shqimit në librat kadastral e ka kuptuar se pronar i patundshmërisë të cilën e kishte blerë nga vëllai D.a, ka dal në emër të N. (Sokol) M..

Se prona i është shitur N. M., përmes babait të tij S., gjykata këtë rrethanë e ka vërtetuar edhe nga deklarata e dëshmitarit Sokol, i cili ka pohuar se nga i akuzuari E.A., ka blerë patundshmërinë në fshatin ....., Komuna Klinë dhe se në llogari të ndryshme i ka bartur të hollat, përkatësisht të hollat në shumë prej 80.000 Euro i ka bartur në emër të I.A. dhe shumë prej 61.700 Euro, në llogari të të akuzuarit E.A..

Gjykata dëshmime të dëshmitarëve/dëmtuarve lidhur me faktet e vërtetuar si më lartë, ua fali besimin meqë ishin objektive dhe reale e po ashtu dhe në përputhje me provat materiale. Këta dëshmitar të cilët u dëgjuan para trupit gjykues, vërtetuan në mënyrë të saktë dhe të plotë se i akuzuari E.A., me qëllim të përfitimi të kundërligjshme të dobisë pasurore për vete edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se prona është evidentuar në emër të dëmtuarit D.A. dhe se e njëjtën në vitin 2010 ua ka shitur të dëmtuarve B., derisa të njëjtën pronë ia shet N. M., përmes babait të tij S.M. .

Se prona ishte shitur kjo vërtetohet edhe nga prova materiale e administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, përkatësisht nga kontrata mbi shitblerjen e patundshmërisë e datës 18.07.2018, për ngastrat kadastrale numër P-01367-0 dhe P-01376 Zona Kadastrale ....., si dhe kontratat mbi shitblerjen e patundshmërisë e datës 28.01.2019, për ngastrat kadastrale numër P-01349-4 dhe P-01371-0. Kjo rrethanë vërtetohet edhe nga certifikata e patundshmërisë e lëshuar nga Zyra Kadastrale e Komunës së Klinës e datës 05.11.2021.

Gjykata ka vlerësuar dhe mbrojtjen e të akuzuarit, i cili pretendon se prona objekt gjykimi nuk i është shitur dëshmitarëve/dëmtuarve M., por është lënë peng deri në marrjen e një prone tjetër, mirëpo një pretendim i tillë nga ana e gjykatës u vlerësua si jo i besueshëm dhe në kundërshtim të plotë me deklaratat e dëshmitarëve/dëmtuarve si më lartë, por edhe me provat materiale përkatësisht kontratat mbi shitblerjen e patundshmërive dhe certifikatën e patundshmërisë të elaboruara si më lartë.

Gjykata nga provat e administruara gjen se i akuzuari E.A., me anë të paraqitjes së rreme të fakteve, me qëllim të përftimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten, i ka mashtruar N.

e S.M. , duke ia shitur pronat e evidentuara në emër të dëmtuarit D.A., pa autorizimin e këtij të fundit.

Gjykata rikujton se veprimet e të akuzuarit E.A., janë të përcaktuara si vepër penale sipas Kodi Penal të Republikës së Kosovës, si vijon:

*“Përveç siç parashihet në nenin 336 të këtij Kodi, kushdo që me anë të paraqitjes së rreme të fakteve apo duke fshehur faktet dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten apo personin tjetër, ose për t’i shkaktuar dëm material personit tjetër, e mashtron apo vazhdon lajthimin e personit tjetër dhe me këtë e nxit një person që të kryej apo të mos kryej një veprim në dëm të pasurisë së tij apo të pasurisë së personit tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.*

*Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me dobi pasurore të kundërligjshme ose shkakton dëme në vlerë prej dhjetëmijë (10.000) Euro apo më shumë, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.”*

Në bazë të të gjitha provave të administruara në shqyrtim gjyqësor, përtej çdo dyshimi gjykata ka vërtetuar se i akuzuari E.A., ka kryer veprën penale *Mashtrim nga neni 335 par.2 lidhur me par.1 të KPPRK-së.*

#### Rikualifikimi ligjor i veprës penale

PTHDKR në Pejë, siç është potencuar dhe me lartë e ka ngarkuar të akuzuarin me veprën penale të kryer në vazhdimësi *Mashtrim nga neni 335 par.2 lidhur me par.1 dhe neni 88 të KPRK-së.*

Gjykata ka vlerësuar të gjitha pretendimet e prokurorisë në raport me përshkrimin faktik të aktakuzës, provave që janë administruar në shqyrtim gjyqësor, referuar dhe dispozitës së nenit 359 par.2 të KPPRK-së, në këtë rast ka ndryshuar përshkrimin e gjendjes faktike dhe ka ricilësuar veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që kualifikimi ligjor për të akuzuarin E.A., nuk ka qenë në përputhje me gjendjen faktike të vërtetuar pas administrimit të të gjitha provave si personale dhe materiale, pas parasysh se për veprën penale nën pikën VII të aktakuzës, gjykata të akuzuarin E. e ka liruar nga akuza për arsyet të cilat do paraqiten në vijim të arsyetimit të këtij aktgjykimi, andaj dhe në raport me veprën penale nën pikën VIII të aktakuzës, ka heq vazhdimësinë meqenëse ky kualifikim juridik ka qenë i ndërlidhur me këtë pikë të aktakuzës.

Gjykata në përshkrim faktik të aktgjykimit nuk ka ndryshuar përmbajtjen e akuzës, sa i përket kohës, vendit, të akuzuarit, por ka ndryshuar vetëm kualifikimin ligjor të veprës penale sa i përket

vazhdimësisë. Pra, gjendja faktike e përshkruar në aktgjykim përputhet me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe një mundësi e tillë është e lejuar me dispozitën ligjore të nenit 359 të KPPRK-së, e cila ka përcaktuar në mënyrë të qartë se “Gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës”, si dhe dispozitën e nenit 360 të KPPRK-së, sipas të cilës rrjedh se gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe në provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor.

### Matja e dënimit

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 70 të KPRK-së, si rrethanë rënduese gjykata vlerësoi shkallën përgjegjësisë penale, dashjen direkte si formë më të rëndë të fajit, raportet familjare në mes të dëmtuarit D.A. dhe të akuzuarit, e po ashtu dëmin e shkaktuar të dëmtuarve. Ndërsa, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin është marrë për bazë, sjelljet e tij në gjykatë, në raporte me gjykatën dhe palët, si dhe fakti se është familjar dhe mbajtës i familjes.

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljet dhe rrethanat e kryesit, siç e përcakton neni 69 të KPRK-së, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e tij, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e kryesve, si dhe do të ndikojë tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, si dhe për programin për kompensimin e viktimave të krimit, është marrë në bazë të nenit 452 par.1, lidhur me nenin 449 par.2 pika 2.6 dhe 2.9 të KPPRK-së.

Vendimi lidhur me udhëzimin e të dëmtuarit N. e S.M. , për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil, u morr konform nenit 462 par.2 të KPPRK-së.

### Pika II dhe III

#### Faktet jokontestuese



Gjykata pas administrimit të provave në seancën e shqyrtimit kryesor, e në kuptim të nenit 360 të KPPRK-së, duke i vlerësuar me ndërgjegje çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, e në bazë të vlerësimit të tillë ka vendosur si në pikën II të dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nuk ishte kontestuese se i akuzuari B. G., që nga viti 2014, ushtron profesionin e noterit, në Komunën e Klinës.

Nuk ishte kontestuese se me datë 13 qershor 2017, i akuzuari B. G., ka përpiluar autorizim gjeneral LRP.nr.3107/2017, në zyrën noteriale, ku ishte autorizuar B.A. , nga këtu i dëmtuari D.A., me kërkesë të E.A..

Nuk ishte kontestuese se në autorizim LRP.nr.3107/2017, në vend të D.A., ishte nënshkruar i akuzuari S.K., i cili autorizim ka rezultuar i falsifikuar, sipas raportit të ekspertimit AKF/2020-0488/2020-437 i datës 25.03.2020.

Nuk ishte kontestuese se në bazë të autorizimit të falsifikuar, ishte marrë kredi në institucionin bankar BKT, në shumë prej 250.000,00 €, në emër të të akuzuarit B.A. , si përfaqësues i biznesit N.T.T. “.....” me pronar D.A. dhe nga i akuzuari B. G., ishte përpiluar kontratë mbi hipotekën LRP.nr.3122/2017 dhe Ref.nr.838/2017, e datës 13.06.2017.

Nuk ishte kontestuese se në bazë të kontratës mbi hipotekën LRP.nr.3122/2017 dhe Ref.nr.838/2017 e datës 13.06.2017, BKT, si hipotekëmarrëse bazuar në autorizimin e falsifikuar LRP.nr.3107/2017, ka vënë në hipotekë paluajtshmeritë-lokal dhe toka të regjistruara sipas certifikatave të pronës të administruara si provë.

Nuk ishte kontestuese se në bazë të autorizimit të falsifikuar LRP.nr.3107/2017, ishte lidhur marrëveshje mbi pengun me numër 8206/17 e datës 13.06.2017, mes BKT si pengmarrës dhe të akuzuarit B.A. si pengdhënës, e cila marrëveshje kishte të bëjë me të drejtat që ishte bazuar në atë autorizim, me rastin e marrjes së kredisë nga BKT, përkatësisht duke lënë peng llogaritë bankare në emër të të dëmtuarit D.A. dhe biznesit të tij N.T.T. “.....” gjerë në pagimin definitiv të kredisë dhe interesave që dalin nga kredia e siguruar.

Nuk ishte kontestuese, se të gjitha pronat e hipotekuara kishin kaluar në pronësi të BKT, sipas Aktvendimit për regjistrimin e të drejtave në regjistrin e të drejtave të pronës së paluajtshme me numër 10-921b-2019 të datës 26.11.2019.

Nuk ishte kontestuese se në bazë të autorizimit të falsifikuar si më lartë, ishte përpiluar kontratë për shitblerje nga i akuzuari B. G. mes kontraktuesve B.A. si shitës dhe N. M. si blerës, me numër LRP.nr.641/2019 dhe Ref.nr.144/2019 e datës 28.01.2019, me të cilën kontratë ishin shitur pronat e pronarëve faktik këtu të dëmtuarve M. A. dhe M. Xh. B..

Nuk ishte kontestuese se i akuzuari B.G., me kërkesë të akuzuarit B. G., kishte shkuar tek familja A., për të marrë nënshkrimin nga D.A..

Nuk ishte kontestuese se i akuzuari E.A., i cili ishte klient i rregullt i zyrës noteriale tek B. G., kishte kërkuar që autorizimi të nënshkruhet në shtëpinë e tyre.

Nuk ishte kontestuese se i akuzuari S.K., kishte nënshkruar autorizimin gjeneral i përpiluar në emër të të dëmtuarit D.A..

### Faktet kontestuese

Kontestuese deri në fund të shqyrtimit gjyqësor, mbeti rrethana nëse i akuzuari B. G., e kishte kryer apo jo veprën penale si në pikën I, II, III dhe IV të aktakuzës dhe se veprimet e tij a përbëjnë vepër penale.

Kontestuese deri në fund të shqyrtimit gjyqësor, mbeti rrethana nëse i akuzuari B.G., kishte ndihmuar kryerjen e veprës penale si në pikën V të aktakuzës.

Kontestuese deri në fund të shqyrtimit gjyqësor, mbeti rrethana nëse të akuzuarit E.A., B.A. dhe S.K., kishin kryer veprën penale në bashkëkryerje me të akuzuarin B. G. si në pikën IV të aktakuzës.

Kontestuese deri në fund të shqyrtimit gjyqësor, mbeti rrethana nëse të akuzuarit E.A., B.A. , kanë kryer vepër penale si në pikën VI dhe VII të aktakuzës.

Në vlerësim të deklaratës së dëshmitarit/dëmtuarit D.A., kjo gjykatë vërtetohet të gjitha rrethanat jokontestuese, përkatësisht vërtetohet faktin se ai ishte pronar i biznesit familjar N.T.T. “.....” në Klinë dhe menaxhohej edhe nga vëllai i tij E.A..

Vërtetohet faktin se, për shkak të një veprë penale kishte rënë në burg dhe se gjatë kohës sa ishte në vuajtje të dënimit nga data 22.05.2012 deri me datë 31.08.2017, kishte autorizuar vëllain e tij E.A., tek noteri B. G., që të ndërmerre veprime në kuadër të biznesit të tyre, pasi ai menaxhonte kamionët, derisa E.u autobusët.

Vërtetohet faktin se pasi ka dal nga burgu, kishte shkuar të punojë në Itali dhe diku në vitin 2018 ishte kontaktuar nga BKT, lidhur me rënien në vonesë të pagimit të kësteve të kredisë, të marrë në emër të tij, bazuar në autorizimin e vërtetuar tek noteri B. G..

Vërtetohet faktin se lidhur me këtë kishte kontaktuar B. G., për t'i dhënë sqarim se për çfarë autorizimi bëhej fjalë.

Vërtetohet faktin se posa kishte pranuar autorizimin e dërguar nga noteri, ka parë se nuk ishte nënshkrimi i tij.

Vërtetohet faktin se me të ardhur në Kosovë i ka takuar vëllezërit dhe nga E.a e ka kuptuar se ai i kishte bërë të gjitha, pra të gjithë i kishte vënë në lajthim, lidhur me autorizimin, mbi bazën e të cilit ishin ndërmarrë të gjitha veprimet tjera të përpilimit të akteve noteriale nga ana e të akuzuarit B. G..

Se ishte falsifikuar autorizimi, këtë e vërtetohet dhe i akuzuari B.A. , i cili mes tjerash tha se të gjitha veprimet i kishte ndërmarrë nga besimi që ka pas nga E.a, pra ka besuar që autorizimi është nënshkruar nga D. dhe nuk ishte në dijeni se ai autorizim nuk ka qenë në rregull, këtë e kishte kuptuar kur D. ishte kthyer nga Italia, rrethanë e vërtetuar dhe nga i akuzuari E., i cili tha se të gjithë i kishte vënë në lajthim.

Se në bazë të autorizimit të falsifikuar me shenjë LRP.nr.3109/2017, ishte përpiluar kontratë mbi hipotekën me shenjën LRP.nr.3122/2017, Ref.nr.838/2017 e datës 13.06.2017 e lidhur tani në mes të B.A. si hipoteklënës i autorizuar nga vëllai i tij D.A., në njëri anë dhe Bankës Kombëtare Tregtare në anën tjetër si hipotekmarrëse, në emër të kredisë së marrë me të njëjtin

autorizim në BKT, në shumë prej 250.00.00 (dyqind e pesëdhjetë mijë) €, përpiluar tek noteri këtu i akuzuari B. G., vërtetuan provat materiale që kanë të bëjnë me kontratën në fjalë dhe marrjen e kredisë, e pa mohuar nga i akuzuari B. G., B. dhe E.A..

Se në zyrën e të akuzuarit B. G. është përpiluar Autorizimin me shenjë LRP.nr.3109/2017, në emër të këtu të dëmtuarit D.A. – si autorizues, pa qenë në dijeni e prezent ky i fundit dhe pa e vërtetuar më nënshkrimin e tij, vërtetojë i akuzuar B. G. dhe B.G. si dhe të akuzuarit A. dhe dëshmitari/ dëmtuari D.A..

Se me datë 28.01.2019 në Klinë, i akuzuari B. G., kishte përpiluar dhe vërtetuar me nënshkrim e vulë, kontratën nën shenjë LRP.nr.641/2019 të shitblerjes së ngastrës P-71010027-01349-4, në sipërfaqe 500 m2, Zona Kadastrale .....në emër të B.A. si i autorizuar i të dëmtuarit D.A. – si shitës në njërin anë dhe nga ana tjetër N. M. nga fshati ....., Komuna Klinë si blerës, në shumë prej 9.000.00 (nëntëmijë) €, vërtetuan provat materiale që kanë të bëjnë me kontratën në fjalë e pamohuar nga vet i akuzuari B. G., fakt i vërtetuar nga i dëmtuari/dëshmitari N. M..

Se me datë 28.01.2019 në Klinë, i akuzuari B. G., si person zyrtar – noter kishte përpiluar kontratë për shitblerjen e patundshmërisë me numër LRP.nr.641/2019 dhe ref.nr.144/2019 në mes të B.A. si shitës e në anën tjetër N. M., si blerës të patundshmërive të cilat evidentohen në emër të D.A. sipas certifikatave për paluajtshmeritë 11-292-20219 dhe 11-268-2019, njësit kadastrale me numër P-71010027-01349-4 ZK .....në sipërfaqe prej 500 m2, e të cilat përndryshe ishin prona faktike të M. e Xh. B., si dhe parcelën me numër P-71010027-01371-0 ZK ....., në sipërfaqe 1829 m2, në shumë prej 143.000.00 (njëqind e dyzet e tre mijë) €, e cila ishte pronë faktike e të dëmtuarit M. A., vërtetuan pos provave materiale në fjalë dhe i akuzuari B. G. si dhe të akuzuarit A. e në veçanti kjo u dëshmuua nga deklaratat e dëshmitarit S.M. dhe M. A..

Se me datë 13.06.2017, në fshatin ....., Komuna Klinë, ishte nënshkruar autorizimi LRP.nr.3109/17, nga i akuzuari S.K., i përpiluar në zyrën e të akuzuarit B. G., pas kërkesës së të akuzuarit E.A., që të shkojë në shtëpi të familjes A., për të marrë nënshkrimin e të dëmtuarit D.A., pasi ky i fundit ishte në një pushim vikendi nga vuajtja e dënimit, ku autorizimi në fjalë i ipet të akuzuarit B.G., asistent në zyrën e të akuzuarit B., që të shkojë për marrje të nënshkrimit, e me të cilin ishte autorizuar B.A. , që të përfaqësojë D.A., për shitjen e të gjitha patundshmërive të evidentuara në emër të biznesit të të dëmtuarit N.T.T. “.....”, si dhe patundshmërive tjera të evidentuara në emër personal të të dëmtuarit D. të cilat gjenden në Zonën Kadastrale Klinë dhe

.....Komuna Klinës, i akuzuari B. e vërteton nënshkrimin me vulë noteriale, e i cili autorizim ka rezultuar më pas i falsifikuar sipas ekspertizës grafologjike, vërtetuan të akuzuarit G. dhe A., si dhe dëshmitarët D.A., M. A. dhe dëshmitari M..

Andaj, gjykata konstaton se deklaratat e dëshmitarëve sa i përket fakteve jokontestuese duhet fal falë besimin, sepse deklaratat e tyre ishin në përputhje të plotë e të mbështetura në të gjitha provat materiale të cilat janë vlerësuar të ligjshme.

Në raport me faktet kontestuese gjykata bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar, do të jep vlerësim për secilin të akuzuar veç e veç.

*Vlerësimi i gjendjes faktike të vërtetuar për të akuzuarin B. G.*

*Prokuroria pretendon se i akuzuari G. , e ka kryer veprën penale në vazhdimësi Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.2 nënpar.2.2 lidhur me par.1 e nenin 81 të KPRK-së, si në pikën I të aktakuzës dhe vepër penale në bashkëkryerje falsifikim i dokumentit nga neni 434 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.*

Vepra penale *Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 të KPRK-së*, për të cilën është ngarkuar i akuzuari B. G., përbëhet nga elementet objektive e që janë veprimi dhe pasoja (Actus Reus) ashtu si dhe nga qëllimi kriminal (Mens rea) lidhur me secilin element të veprës penale. Për të ekzistuar një vepër penale, këto elemente duhet të përmbushen në mënyrë kumulative. Vepra penale në fjalë, si e tillë, mund të kryhet me veprim dhe vetëm me dashje direkte të kryesit. Kur jemi tek dashja, e njëjta duhet të paraqitet si në veprim e poashtu edhe në pasojë, sidomos tek vepra penale që është objekt shqyrtimi, pasi që forma të tjera të fajit, tek kjo vepër nuk mund të vijnë në shprehje.

Veprimi kriminal i të akuzuarit B. G., e po ashtu edhe pasoja, që të dyja këto elemente objektive mbi bazën e gjendjes faktike është gjetur se nuk janë plotësuar, sepse nga elaborati i mësipërm i provave materiale e po ashtu edhe atyre personale, e që janë dëshmitë e dëshmitarëve, është vërtetuar se i akuzuari B., ka ndërmarrë veprime e të cilat edhe kanë shkaktuar pasojën, mirëpo, çështja tani është se këto veprime të tij, a lidhen me qëllimin kriminal të cilin e ka pasur i akuzuari, respektivisht nëse qëllimi i tij kriminal të ketë qenë të kryhet vepra penale për të cilën edhe është akuzuar, pra e domosdoshme është që të ketë ekzistuar relacioni psikik (mendor) i të akuzuarit me veprën e tij dhe pasojat e asaj vepre. Pavarësisht kësaj, gjykata tërheq vëmendjen

se vepra penale *keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 të KPRK-së*, si objekt të mbrojtjes të saj e ka detyrën zyrtare, e cila hynë në kategorinë e veprave penale të njohura si *delicta propria*, e të cilat mund të kryhen vetëm nga një kategori e caktuar e personave. Konkretisht, këto vepra penale mund t'i kryejnë personat të cilët janë bartës të këtyre autorizimeve zyrtare apo personat që kanë kompetenca për të kryer autorizimet zyrtare të caktuara, e që në rastin konkret i akuzuari B., me profesion noter, kishte këtë cilësi.

Dilemat rreth këtij fakti nuk u evituan deri në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, sepse me asnjë provë personale apo materiale, gjykata nuk mundi të vërtetojë në mënyrë të sigurt dhe të padyshimtë se vërtetë i akuzuari B. G., kishte keqpërdorë detyrën zyrtare, ashtu siç pretendohet në aktakuzë.

Pretendimi i akuzës se *“i akuzuari duke mos i përmbush detyrat zyrtare të tij ka pas qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose personin tjetër”*, nuk u vërtetua me provat e administruara, se cili ishte përfitimi i të akuzuarit me rastin e mos veprimit, si trajtë tjetër e veprës penale apo marrëveshja me personin e tretë që përfitojë, apo t'i shkaktojë dëm personit tjetër, pra lidhja kauzale e të akuzuarit, se kishte qëllim të përfitimit për personin tjetër, duke mos i përmbushur detyrat si noter.

Po ashtu prokuroria pretendon se i akuzuari B. G., se të gjitha veprimet i ndërmori në bazë të autorizimit të falsifikuar, megjithatë nuk ka arritur të vërtetojë se i akuzuari B. G., ka qenë në dijeni rreth faktit se autorizimi nuk është nënshkruar nga i dëmtuari D.A., por nga i akuzuari S.K., këtë gjë nuk ka arritur të provojë as prokuroria me asnjë provë te vetme.

I akuzuari B., në mbrojtjen e tij ka theksuar se duke pasur besim tek E.a dhe vëllezërit tjerë, të cilin kishin raporte të mira në mes vete, me kërkesën e të akuzuarit E., ka përpiluar një autorizim gjeneral në zyrë, ndërsa punëtori i tij ka shkuar tek shtëpitë e A., për marrje të nënshkrimit për shkak të pamundësisë së autorizimdhënësit për të shkuar në zyre. Pasi i akuzuari B.G., është kthyer në zyre dhe i ka konfirmuar se çdo gjë ka shkuar në rregull lidhur me marrjen e nënshkrimit, ai ka vazhduar me veprime tjera si rrjedhojë e autorizimit.

Sipas vlerësimit të gjykatës, mbrojtja e të akuzuarit B., është plotësisht e besueshme pasi që përputhet tërësisht me mbrojtjen e të akuzuarve B.G., E.A., por pjesërisht edhe me deklaratën e të dëmtuarit D.A., i cili pohoj se E.a i kishte thënë se të gjitha i kishte bërë vetë, e po ashtu edhe

me mendimin e dhënë nga Oda e Noterëve me numër të referencës 4/22 i datës 24.01.2022, ku ndër të tjera është thënë se marrja e nënshkrimit duhet të bëhet nga vet noteri, e të cilin mund ta asistojë edhe punëtori apo praktikanti i zyrës dhe se në rastin konkret noteri ka vepruar me mirëbesim duke e dërguar punëtorin e zyrës për nënshkrim. Po ashtu kanë shtuar, se i akuzuari B. është mashtruar me dashje nga vëllai i të dëmtuarit, këtu i akuzuari E. dhe se qëllimi i noterit nuk ka qenë për ta ndihmuar autorizim marrësin e as për ta dëmtuarin vëllain e tij, në emër të cilit ka kërkuar autorizimin e dyshuar, nga fakti se noteri me mirëbesim ka vepruar kur e ka dërguar punëtorin e vet për të marrë nënshkrimin e palës.

Sa i përket deklaramit të dëshmitarit Sh. H., i cili tha se përpilimin e aktit noterial mund ta bëjë bashkëpunëtori apo i punësuar në zyrën noteriale, por noteri duhet të jetë prezent si në zyre ashtu edhe jashtë zyrës me rastin e marrjes së nënshkrimit nga klienti, gjykata të njëjtën e morri jo relevante dhe jo me ndikim për vendosje ndryshe, pas parasysh se një deklaramit i tillë është në kundërshtim të plotë me mendimin e dhënë nga Oda e Noterëve me numër të referencës 4/22 i datës 24.01.2022, pjesë e të cilit ka qenë ky dëshmitar.

Pra nga këto rrethana dhe prova, rrjedh se i akuzuari B., nuk e ka ditur dhe as nuk ka mundur ta dije se autorizimi gjeneral LRP.nr.3109/2017 i përpiluar nga ai në zyre, nuk është nënshkruar nga i dëmtuari D.A., pas parasysh se i akuzuari B.G., i kishte konfirmuar se gjithçka ka shkuar në mënyrë të rregullt me rastin e marrjes së nënshkrimit tek familja A.. Për këto arsye i akuzuari B. G., duke iu referuar autorizimit gjeneral LRP.nr.3109/2017, ka ndërmarrë veprime tjera juridike, objekt akuze, përkatësisht ka përpiluar kontratat për shitblerje dhe vënie të patundshmërive në hipotekë.

Gjykata rikujton se për të provuar se është kryer vepra penale e keqpërdorimit të detyrës apo autoritetit zyrtar, përkatësisht forma e veçantë mospërputhja e detyrës zyrtare, duhet të paraqiten prova, pasi nuk mjafton që akuzat të parafrzojnë përshkrimin e veprës penale. Për gjykatën është e qartë se si rrjedhë e autorizimit të falsifikuar i është shkaktuar dëm të dëmtuarve, mirëpo prokuroria nuk ka arritur të vërtetojë faktin se kjo është bërë me dashje dhe qëllimisht nga i akuzuari B., pas parasysh se kjo veprë penale mund të kryhet vetëm me dashje të drejtpërdrejtë. Dërgimi i punëtorit të tij këtu të akuzuarit B.G., për marrje të nënshkrimit tek familja A., nuk konsumon elementet e kësaj vepre penale, përkatësisht nuk është i mjaftueshëm për të ardhur në përfundim se i njëjti ka kryer këtë veprë penale.

Për më tepër sipas deklaratave të të dëmtuarve D.A., M. B., M. A., janë vërtetuar rrethanat se si e kanë kuptuar lidhur me marrjen e kredisë në vlerë prej 250.000 Euro, në BKT, si janë shitur disa nga patundshmëritë në emër të biznesit dhe në emër të dëmtuarit D.A., e po ashtu se si janë vënë disa prej tyre në hipotekë. Pra, këta dëshmitarë përveç këtyre rrethanave nuk vërtetuan ndonjë rrethanë tjetër të cilin gjykata do të mund ta ndërlidhte me veprime inkriminuese të pretenduara sipas aktakuzës për të akuzuarin B.. Të gjithë njëlloj thanë se i akuzuari E.A., i kishte mashtruar të gjithë.

Po ashtu dhe dëshmitarja E. A., nuk vërtetoi ndonjë veprim inkriminues të të akuzuarit B., meqë sipas saj ajo kishte shkuar në zyre noteriale pasi ka qenë e detyruar nga i akuzuari E., ndërsa pretendimi i saj se nuk i është lexuar asgjë me rastin e nënshkrimit, mbeti i pa mbështetur në prova tjera.

Gjykata dëshmisë së këtyre dëshmitarëve si më lartë, ua fali besimin meqë të njëjtat ishin në përputhje me njëra tjetrën dhe me provat materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Prokuroria pretendon se i akuzuari B. G., ka vepruar në kundërshtim me nenin 33, 38 e 45 par.1 e 2 të Ligjit për Noterinë Nr.03/L-010, gjykata me rastin e administrimit të provave në veçanti mendimit të dhënë nga Oda e Noterëve, e po ashtu edhe nga deklarata e dëshmitarit Sh. H., është gjetur se është dashur të respektohen dispozitat ligjore në fjalë, mirëpo gjykata në asnjë mënyrë nuk ka pasur mundësi të vërtetojë dashjen e tij direkte për të ndërmarrë veprime inkriminuese me qëllim të përfitimit apo shkakimit të dëmit tjetrit. Të gjitha këto lëshime mund të tërheqin procedurë disiplinore, por jo edhe përgjegjësinë penale.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret aktakuza e prokurorisë në raport me pretendimet si më lartë, nuk është e mbështetur në prova siç parashihet me Kodin e Procedurës Penale dhe referuar dispozitës së nenit 3 paragrafi 3 të këtij Kodi, ku përcaktohet parimi “*in dubio pro reo*”, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij, sipas këtij Kodi dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të akuzuarin B. G., e liroj nga aktakuza.

Të akuzuarit B. G., E.A., B.A. dhe S.K., sipas aktakuzës akuzohen për vepër penale *Falsifikim i dokumentit zyrtar nga neni 434 par.1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së.*



Gjykata, duke u bazuar në provat e administruara nuk ka arritur të vërtetojë se të akuzuarit B. G., E.A., B.A. dhe S.K., kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar sipas aktakuzës së prokurorisë.

Përkatësisht, gjykata nuk ka arritur që të vërtetojë se i akuzuari B. G., ka pasur marrëveshje me të akuzuarit tjerë në mënyrë që t'i mundësojë të akuzuarit S.K., falsifikimin e dokumentit zyrtar përkatësisht të autorizimit me shenjën LRP.nr.3109/2017.

Për gjykatën nuk ka qenë kontestues se autorizimi me shenjën LRP.nr.3109/2017, është falsifikuar, mirëpo bazuar në deklaratat e dëshmitarëve si dhe vetë mbrojtjen e të akuzuarve, gjykata nuk ka arritur të vërtetojë pretendimet e prokurorisë në raport me të akuzuarin B. G., përkatësisht se *“me datë 13.06.2017, në fshatin ....., Komuna Klinë, i pandehuri B., si person zyrtar, në marrëveshje e bashkëveprim me të pandehurit tjerë i ka mundësuar të pandehurit S. të falsifikoj dokumentin zyrtar me të dhëna të rremë dhe atë autorizimin LRP.nr.3109/2017”*.

Sipas këtij përshkrimi faktik, prokuroria pretendon se i akuzuari B. G., i ka mundësuar të akuzuarit S. të falsifikoj dokumentin zyrtar me të dhëna të rremë dhe atë autorizimin LRP.nr.3109/2017, mirëpo mbi bazën e provave të administruara nuk u vërtetua se i akuzuari B. G., i mundësojë të akuzuarit S., falsifikimin e dokumentit zyrtar.

Gjykata ka vërtetuar se i akuzuari B. G., me kërkesën e vëllait të dëmtuarit D.A., E.A., ka përpiluar autorizimin me shenjën LRP.nr.3109/2017, në zyrën noteriale.

Po ashtu gjykata ka vërtetuar se i akuzuari B. G., e ka dërguar punëtorin e tij këtu të akuzuarin B.G., për të marrë nënshkrimin në fshatin ....., Komuna Klinë, nga i dëmtuari D.A..

Mirëpo bazuar në deklaratat e dëshmitarëve D.A., M. A., H.A., M. B., S.M. , gjykata nuk arriti të vërtetojë se i akuzuari B. G., i ka mundësuar të akuzuarit S.K., falsifikimin e autorizimit edhe përkundër faktit se ai ishte i obliguar që autorizimi të nënshkruhet në prezencën e tij qoftë në zyre noteriale po jashtë zyrës, mirëpo dërgimi i punëtorit të tij për të marrë nënshkrimin nuk tërheq përgjegjësi penale, kjo mund të ketë qenë ndonjë lëshim nga pakujdesia, por në asnjë mënyrë gjykata nuk mundi të vërtetojë dashjen direkte të të akuzuarit B., për të ndërmarrë një veprim të tillë. Ky veprim sipas të akuzuarve B. dhe B.G., ishte ndërmarrë për shkak të volumit të madh të punës dhe besimit që kishte tek familja A., e në veçanti tek i akuzuari E.A., pasi që

ishte klient i rregullt dhe deri në atë kohë i besueshëm, pas parasysh se kishte dhe një autorizim valid të nënshkruar nga vetë i dëmtuari D.A., pothuajse me përmbajtje krejtësisht të njëjtë

Këtë rrethanë gjykata nuk arriti të vërtetojë as me mbrojtjen e të akuzuarve A., K. si dhe B.G., e aq më tepër kur i akuzuari E.A., në mbrojtjen e tij pohoj se i ka mashtruar të gjithë të akuzuarit, përfshirë dhe të akuzuarin B. G.. Ndërsa i akuzuari K. , mohoj ta ketë njohur me parë të akuzuarin B., rrjedhimisht dhe t'i ketë mundësuar falsifikimin e dokumentit, pas parasysh se ai tha se ditën kritike kur i akuzuari E. i kishte thënë të nënshkruaj autorizimin ka qenë i dehur dhe se i akuzuari E. i kishte thënë se ka të bëjë me lirimin e vëllait të tij këtu të dëmtuarit D.A., pra nuk ishte në dijeni se është duke u nënshkruar për të dëmtuarin D..

Dispozita e nenit 31 të KPRK-së, parasheh:

*“Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale”.*

Në rastin konkret gjykata me asnjë provë nuk ka vërtetuar se të njëjtit kanë vepruar në bashkëkryerje, marrë parasysh dhe deklaratën e të akuzuarit B.G., i cili tha se ditën kritike pasi kishte marrë nënshkrimet tek familja A., ai i kishte konfirmuar të akuzuarit B. se autorizimi me shenjën LRP.nr.3109/2017, ishte nënshkruar nga i dëmtuari D.A. dhe se çdo gjë kishte shkuar në rregull, pra ai nuk ishte në dijeni fare se autorizimi në fjalë nuk ishte nënshkruar nga personi në emër të të cilit ishte përpiluar sipas kërkesës së të akuzuarit E.A..

Gjykata, rikujton se sipas nenit 47 të KPPRK-së, prokurori i shtetit ka për obligim që gjatë hetimit të veprave penale të analizojë provat dhe faktet fajësuese dhe shfajësuese dhe të siguroj që një hetim të kryhet duke respektuar në tërësi të drejtat e të pandehurit dhe që mbledhja e provave të mos bëhet në kundërshtim me Kapitullin XVII të këtij kodi. Gjithashtu, duke u bazuar në nenin 236 të KPPRK-së, përcaktohet se në akuzë duhet të jepen shpjegimet e arsyeshme për ngritjen e akuzës bazuar në rezultatin e hetimeve dhe provave që i vërtetojnë faktet kryesore, ndërsa në rastin konkret prokuroria, nuk kishte siguruar prova, pothuajse asnjë provë të vetme me të cilën do të vërtetohej që i akuzuari B. G., ka ndërmarrë veprimet inkriminuese në raport me veprën penale të keqpërdorimit apo në cilësi të bashkëkryerësit ka kryer veprën penale të falsifikimit të dokumentit zyrtar.

Ndërsa në raport me të akuzuarit E.A., B.A. dhe S.K., referuar dispozitës ligjore nga neni 434 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, e cila parasheh citat:

*“Personi zyrtar i cili në dokumentin zyrtar, në regjistër ose në shkresën zyrtare shënon të dhëna të rreme ose nuk shënon të dhënat e duhura apo me nënshkrimin e tij ose me vulën zyrtare vërteton dokumentin zyrtar, regjistrin apo shkresën zyrtare e cila përmban të dhëna të rreme ose mundëson përpilimin e dokumentit, regjistrin ose shkresës së tillë me përmbajtje të rreme, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.”*

Gjykata ka ardhur në përfundim se vepra penale e falsifikimit të dokumentit zyrtar nga neni 434 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, mund të kryhet vetëm nga personi zyrtar ose personi përgjegjës, e që në rastin konkret të akuzuarit E.A., B.A. dhe S.K., nuk e kanë cilësinë e personave zyrtar.

Këtë rrethanë gjykata e ka vërtetuar nga dëgjimi i dëshmitarëve por edhe nga vetë mbrojtja e të akuzuarve të cilët nuk deklaruan se kanë ndonjë pozitë zyrtare apo janë persona përgjegjës. Këtë pretendim të prokurorisë gjykata nuk arrit të vërtetojë as nga provat materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, mbi bazën e të cilave do të mund të vihej në përfundim se të njëjtit kanë pozitën e personave zyrtar.

#### Pika IV

Ndërsa sa i përket të akuzuarit B.G., prokuroria në dispozitivin e V të aktakuzës pretendon se *“me datë 13.06.2017, në fshatin ....., Komuna Klinë, si asistent noterial në zyrën e noterisë “B. G. BI”, ndihmon në kryerjen e veprës penale të falsifikimit të dokumentit zyrtar, në atë mënyrë që me marrëveshje me të pandehurin B. G. e E.A., e me dijeninë e të pandehurit B.A. , e dërgon autorizimin LRP.nr.3109/2017, të cilin e kishte përpiluar paraprakisht i pandehurit B. në shtëpinë e të pandehurit E.A., për të nënshkruar i pandehuri S.K. në vend e padijëninë e të dëmtuarit D.A..”*

Mbrojtësi i të akuzuarit B.G. av.Ardian Deskaj dhe i akuzuari B.G., kanë kundërshtuar pretendimet e aktakuzës, me arsyetimin se i akuzuari B.G., nuk ka pasur marrëveshje me asnjërin

nga të akuzuarit për falsifikim të dokumentit dhe se i njëjti ishte vënë nën lajthim nga i akuzuari E.A..

Gjatë shqyrtimit gjyqësor me rastin e dëgjimit të dëshmitarëve, administrimit të provave materiale, por edhe referuar mbrojtjes së të akuzuarve, nuk arriti të provojë se i njëjti ka kryer veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale Falsifikim i dokumentit zyrtar nga neni 434 par.1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, për këto arsye:

Prokuroria, nuk ka arritur të provojë me ndonjë provë qoftë personale apo materiale, se i akuzuari B.G., e kishte cilësinë e personit zyrtar.

Për gjykatën nuk ishte kontestuese se i akuzuari B.G., me datë 13.06.2017, me kërkesën e noterit B. G., ka qenë në fshatin ....., Komuna Klinë, tek familja A., për të marrë nënshkrimin sipas autorizimit nën shenjë LRP.nr.3109/2017, mirëpo referuar provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata nuk arriti të provojë se i njëjti ka pasur cilësinë e personit zyrtar, e që është kusht ligjor për t'u përmbushur elementet e kësaj vepre penale.

Vepra penale e falsifikimit të dokumentit zyrtar nga neni 434 par.1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, në mënyrë shprehimore përcakton:

*“Personi zyrtar i cili në dokumentin zyrtar, në regjistër ose në shkresën zyrtare shënon të dhëna të rreme ose nuk shënon të dhënat e duhura apo me nënshkrimin e tij ose me vulën zyrtare vërteton dokumentin zyrtar, regjistrin apo shkresën zyrtare e cila përmban të dhëna të rreme ose mundëson përpilimin e dokumentit, regjistrin ose shkresës së tillë me përmbajtje të rreme, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.”*

Në rastin konkret gjykata ende pa u leshu në vlerësim të pretendimeve tjera, ka gjetur se i pandehuri B.G., bazuar në provat mbi të cilat është mbështetur aktakuza, nuk e ka cilësinë e personit zyrtar, meqë për t'u vërtetuar një pretendim i tillë, prokuroria është dashur të paraqesë provë materiale me të cilën provohej se i njëjti ka qenë i punësuar në zyre tek noteri B. G., me detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara në kontratë.

Andaj dhe mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar kjo gjykatë, nuk mundi të vërtetojë pretendimet e aktakuzës me asnjë provë të vetme dhe të njëjtit konform nenit 363 par.1, nënpar.1.3 të KPRK-së, e liroj nga aktakuza.

## Pika V

Prokuroria pretendon se “Me datë 13.06.2017 në Pejë, në Bankën Kombëtare Tregtare (BKT e tutje) e në vazhdimësi, në marrëveshje paraprake mes tyre, me paraqitje të rreme të fakteve, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të pasurisë për vete, kanë vu në lajthim zyrtarët e kësaj banke që të kryejnë një veprim i cili rezulton në dëm të pasurisë së saj, në atë mënyrë që me prezantimin e autorizimit gjeneral LRP nr.3109/2017, të falsifikuar me të cilin kinse D.A., si autorizues i të pandehurit këtu B. – si i autorizuar me Kontratë për Hipotekë LRP.nr.3122/2017 ref.nr. 838/2017, përfitojnë shumën prej 250.000.00 (dyqind e pesëdhjetë mijë) € në emër të kredisë, duke lënë me këtë rast peng patundshmërinë e të dëmtuarit D., si lokalin afarist N.T.T “.....” me numër të biznesit 80349262, ngastra nr.O-71006024-00525-17-5-2-13-0, me sipërfaqe prej 26 m2, ZK Klinë e cila pronë është vlerësuar 21.000.00 (njëzetë e njëmijë) €, si dhe patundshmëritë në emër të dëmtuarit D., të evidentuara sipas certifikatës së pronës me numër 11-2459-2017 dhe atë ngastrën P-71010027-01362-0 në sipërfaqe prej 4.444 m2, P-71010027-01363-1, në sipërfaqe prej 3.114 m2, P-71010027-01363-2, në sipërfaqe prej 3.116 m2 dhe P-71010027-01363-4 në sipërfaqe prej 3.076 m2 me 1/1 të pjesës ideale e vlerësuar 409.000.00 (katërqind e nëntë mijë) €, të cilën kredi nuk e paguajnë dhe për pasojë bankës në fjalë i shkaktajnë dëm në shumë prej 217.936.36 (dyqind e shtatëmbëdhjetë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë euro e tridhjetë e gjashtë cent) €.

Me datë 28.01.2019 në Klinë, në vazhdimësi më anë të paraqitjes së rreme të fakteve me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten, me anë të autorizimit të falsifikuar LRP nr.3109/17 me të cilin kinse D.A. autorizon të pandehurin B. për shitjen e të gjitha patundshmërive të evidentuara në emrin e biznesit të të dëmtuarit N.T.T “.....” si dhe patundshmërive tjera të evidentuara në emrin e tij personal të cilat gjenden në ZK Klinë dhe ....., Komuna Klinë, në atë mënyrë që në emrin të kinse gracionit se pronat e shitura me herët nga i pandehuri E. do të barten në emër të dëmtuarit N., i pandehuri B. me ndërmjetimin e të pandehurit E. lidh kontratë për shitblerjen e patundshmërisë nën LRP nr. 641/2019 dhe ref.nr. 144/2019 tek noteri B. G. me të cilën e bartë patundshmëritë të cilat evidentohen në emër të D.A., sipas certifikatës për paluajtshmëritë 11-292-20219 dhe 11-268-2019 si njësi kadastrale me nr.P-71010027-01349-4 ZK .....në sipërfaqe prej 500 m2, e të cilat përndryshe ishin prona faktike të M. dhe Xh. B., si dhe parcelën me nr. P-71010027-01371-0 ZK .....në sipërfaqe prej 1829 m2, e cila ishte pronë faktike e të dëmtuarit M. A., duke i shkaktuar kështu dëme të dëmtuarit N., në shumën prej 143.000.00 (njëqind e dyzetë e tre mijë) €.”

Gjykata mbi bazën e administrimit të provave nuk e gjeti kontestues faktin se në bazë të autorizimit gjeneral LRP.nr.3109/2017 të falsifikuar, në emër të të dëmtuarit D.A., me të cilin ky i fundit kishte autorizuar të akuzuari B.A. , ishte përpiluar kontratë mbi hipotekë LRP.nr.3122/2017 ref.nr. 838/2017, në emër të kredisë në shumë prej 250.000 Euro, të marra në Bankën Kombëtare Tregtare, duke lënë me këtë rast peng patundshmërinë e të dëmtuarit D., si lokalin afarist N.T.T. “.....” me numër të biznesit 80349262, ngastra nr.O-71006024-00525-17-5-2-13-0, me sipërfaqe prej 26 m2, ZK Klinë e cila pronë është vlerësuar 21.000.00 (njëzetë e njëmijë) €, si dhe patundshmëritë në emër të dëmtuarit D., të evidentuara sipas certifikatës së pronës me numër 11-2459-2017 dhe atë ngastrën P-71010027-01362-0 në sipërfaqe prej 4.444 m2, P-71010027-01363-1, në sipërfaqe prej 3.114 m2, P-71010027-01363-2, në sipërfaqe prej 3.116 m2 dhe P-71010027-01363-4 në sipërfaqe prej 3.076 m2 me 1/1 të pjesës ideale e vlerësuar 409.000.00 (katërqind e nëntë mijë) € dhe pasi kredia nuk ishte paguar këto patundshmëri kanë kaluar në emër të BKT. Mirëpo mbi bazën e provave të administruara gjykata edhe përkundër faktit se i akuzuari E.A., ka pohuar se të gjithë i kishte vënë në lajthim, megjithatë për të kryer veprën penale të pretenduar nuk rezultojë i vërtetuar ndonjë veprim i tij, pas parasysh se në të gjitha këto kontrata qoftë edhe marrje të kredisë evidentohet emri i të akuzuarit B.A. , i cili nuk e kontestojë faktin se ishte nënshkruar në të gjitha kontratat përfshirë dhe kontratën mbi hipotekën, mirëpo me asnjë provë nuk u vërtetua se ai ishte në dijeni se të gjitha veprimet ishte duke i ndërmarrë mbi bazën e një autorizimi të falsifikuar, të gjithë dëshmitarët e në veçanti nga mbrojtja e të akuzuarit E.A., u vërtetua se i akuzuari B., ishte vënë lajthim nga ai, se kinse autorizimi ishte nënshkruar nga vetë D. dhe se të gjitha veprimet i kishte ndërmarrë me bindje se ishin të ligjshme, andaj gjykata në mungesë të vërtetimit të dijenisë se i akuzuari B.A. , ishte duke i ndërmarrë veprimet në bazë të autorizimit të falsifikuar, erdhi në përfundim se pretendimet e prokurorisë se kishte marrëveshje paraprake në mes tyre, janë të pabazuara në prova të administruara, qoftë materiale apo personale.

Në raport me të akuzuarin E.A. edhe përkundër se pretendimet e prokurorisë konsistojnë në mashtrim në marrëveshje me të akuzuarin B., për dy vepra penale të kryera në vazhdimësi si në pikën VI dhe VII të aktakuzës, kjo gjykatë erdhi në përfundim se i akuzuari E.A., në të vërtetë i kishte mashtruar që të gjithë, mirëpo i njëjti fshihej pas veprimeve të ndërmarra nga të gjithë të akuzuarit dhe se emri i tij nuk figuronte në asnjë akt noterial që është objekt akuze të përpiluara nga i akuzuari B. G., siç nuk figuron emri i tij as në kontratë mbi hipotekën dhe shitblerjen e patundshmërive të përshkruara në këto dispozitiva të aktakuzës.

Andaj, në mungesë të vërtetimit të ndërmarrjes së veprimeve, gjykata nuk mundi të ndërhyjë në përshkrim faktik të këtyre veprave penale, kjo ka qenë obligim i prokurorie që të vërtetojë në mënyrë të saktë dhe të qartë se kënd e mashtrorë i akuzuari E.A., e që në bazë të provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, në mënyrë bindëse u vërtetua se ai mashtrorë të gjithë të akuzuarit dhe në bazë të këtij mashtrimi pësuan më pas veprimet e të akuzuarve tjerë, për të cilat nuk ishin në dijeni.

Rrjedhimisht, gjykata nuk vërtetojë marrëveshjen paraprake në mes të akuzuari E.A. dhe B.A. , për paraqitje të rreme të fakteve, i akuzuari E.A., mashtrorë të akuzuarin B.A. , andaj gjykata e vlerësojë se do të tejkalohet aktakuza sikurse në përshkrim faktik të këtyre dy veprave penale, të përfshinte veprimet e të akuzuarit E. në raport me të akuzuarin B., pra se paraqitjen e rreme të fakteve e kishte bërë në raport me të akuzuarin B.A. , e i cili me pas nga këto mashtrime dhe lajthime kishte ndërmarrë veprimet si në pikën VI dhe VII të aktakuzës.

Aktgjykimi në këtë rast nuk është përpiluar me shkrim në afatin ligjor. Kryetarja e Trupit Gjyqësor, ka kërkuar nga Kryetari i Gjykatës, lejimin e vazhdimit të afatit ligjor për përpilimin e aktgjykimit. Kryetari i Gjykatës me përgjigjen e datës 3 korrik 2024, ka lejuar zgjatjen e afatit për përpilim të aktgjykimi edhe për 30 ditë shtesë.

Vendimi me të cilin shpenzimet procedurale do të bien në buxhet të gjykatës, në raport me të akuzuarit të cilët janë liruar nga akuza është marrë konform dispozitës së nenit 453 par.1 të KPPRK-së.

Vendimi lidhur me revokimin e masës së përkohshme është marrë konform nenit 468 par.2 të KPPRK-së.

Vendimi me të cilën të dëmtuarit D.A., M. A., H.A., M. B., Xh. B., N. M., S.M. , Banka Kombëtare Tregtare, janë udhëzuar në kontest civil është marrë konform nenit 462 par.3 të KPPRK-së.

Andaj, bazuar në këto rrethana konform dispozitës së nenit 363 par.1, pika 1.3 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
**Departamenti për Krime të Rënda**  
**PKR.nr.113/22**

**Bashkëpunëtorja profesionale**

Elzana Kastrati

**Kryetarja e trupit gjykues**

Nushe Kuka Mekaj

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditë, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Pejë.